

BIBLIOTEKA
SHTETIT

85H-2

K 96. 4

EKREM KRYEZIU



EPOKA
PARA
GJYQIT
DRAMË

8JH-2
K 96.

EKREM
KRYEZIU



EPOKA
PARA
GJYQIT

DRAMË NGA KOSOVA

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

V E T Ë T :

ABDYL FRASHËRI
SULEJMAN VOKSHI
TURSUN BEU

- Zëvendës i kryetarit të
gjiqit
- zyrtar i lartë turk
- kryetar i gjiqit

MEXHID BEU
QAMIL BEU
KONSULLI I RUSISË
KONSULLI I AUSTRO-
HUNGARISË
KONSULLI I ITALISË
KONSULLI I FRANCËS
YMER PRIZRENI
SHAIB SPAHIU
JONUZ ZAHDI
ROJA E BURGUT
IDRIZ SUMO
PLAKU I LAGJES
SË HAXHIYMERIT
DËSHMITARI
ROJA TURKE DHE
PRIJËSA SHQIPTARË

- dëshmitar i rrejshëm

Nga burgu, që gjendet diku në kala të Prizrenit, nxjerrin, të lidhur në pranga, Abdyl Frashërin dhe Sulejman Vokshin.

Në fillim kalojnë nëpër një korridor të errët, pastaj ngjiten shkallëve. Të gjitha kthesat në atë korridor janë të ndriçuara me flakadanë, që më tepër bëjnë tym se dritë. Abdyl është i zbehur, megjithatë ecën krenar. Pas tij shkon Sulejman Vokshi, njeri i shkuar në moshë, po që me qëndrim të bën të kuptosh se para vetes ke një burrë të vërtetë.

Para se të hyjnë në sallën e gjyqit, të dyve ua heqin prangat.

Abdyl, veshur me rroba të Evropës, me duar fshin pluhurin që ka mbi setrën e gjatë. Sulejmani ka këmishë liri, që dikur duhet të ketë qenë e bardhë, hyn në sallë pa u interesuar fare për dukjen e vet.

Salla ku do të bëhet gjyqi është e ndriçuar me një llampë të madhe në mes. Në njërin nga muret, ka dritare të vogla.

Trupi gjykues, veshur me rroba ushtarake. Në mes tyre Mexhid beu, i cili ka rroba civile.

Kryetari i trupit gjykues, Qamil beu, është një burrë i shkuar në moshë, ka gradën e gjeneralit dhe të lë përshtypjen e një njeriu të qetë, i cili këtë gjykim e shikon më tepër nga aspekti filozofik.

Ndërkaq, Tursun beu, një burrë 35-40 vjeçar, ka një fytyrë që vështirë mund ta kuptosh moshën e tij të vërtetë, ashtu si nuk të jep të kuptosh as mendimin e tij të vërtetë, sillet si një ujë i zënë në kafaz dhe çdo butësi e Qamil beut ndaj të akuzuarve, atë e bën shumë nervoz. Ka uniformë ushtarake, po nja dy grada më të ulët se Qamil beu.

Mexhid beu gjatë gjykimit ndërhyr vetëm në raste të posaçme. Në njërin nga këndet e sallës rri procesmbajtësi, qatip ushtarak.

Salla e gjyqit është e rrethuar me roja. Në fytyrat e të akuzuarve ka zënë vend një krenari, që flet për vendosmërinë e tyre. Mbasi të akuzuarit ulen në vendet e veta, Qamil beu shikon Tursun beun. Ai menjëherë i jep shenjë me dorë Abdyl Frashërit të afrohet aty ku do të përgjigjet.

Qamil beu përsëri i jep shenjë me kokë Tursun beut se mund të fillojë pyetjet.

Tursun beu merr një pozë karakteristike, që do ta ketë shpesh gjatë këtij gjykimi, shikon më parë trupin gjykues dhe pastaj i kthehet të akuzuarit.

TURSUN BEU — Si quhesh?

ABDYLI — Abdyl.

TURSUN BEU — Llagapi?

ABDYLI — Frashëri.

TURSUN BEU — Sa vjeç je?

ABDYLI — Dyzet e gjashtë...

TURSUN BEU — Nga je?

ABDYLI — Nga Dangallia, fshati Frashër.

TURSUN BEU — A di shkrim dhe lexim?

ABDYLI — Po.

TURSUN BEU — Nënshetësia?

ABDYLI — Jam nënshtetas i Perandorisë Osmane.
TURSUN BEU — Zanati?

ABDYLI — Ministër i Punëve të Jashtme i Qeverisë së Përkohshme të Shtetit Shqiptar.
(Tursun beu e shikon Qamil beun që ia merr fjalën. Tursun beu tërhiqet.)

QAMIL BEU — Para se të filloj këtë gjykim të ndritshëm në emër të padishahut, nurit të perëndisë, do ta parafrazoj një ajet nga Kurani Kerim, i cili thotë se Dielli nuk ka nevojë kurrë ta zejë hënën, as nata ta kalojë ditën. Çdo gjë në gjithësi noton. Edhe këtë gjyq e kuptoj kështu... Të kërkosh që nata ta kalojë ditën, do të thotë të mohosh ligjet e perëndisë, të ngresh dorë kundër padishahut, nurit të perëndisë, do të thotë të jesh i padishëm e të mos i kuptosh ligjet e gjithësisë që paraqesin vullnetin e perëndisë. E, dihet fare mirë se nata është natë e dita ditë, dielli diell, hëna hënë... *(E shikon Tursun beun. Tursun beu me një lëvizje të lehtë falënderon, shikon qatipin se a është gati të fillojë shkrimin; i kthehet Abdyl Frashërit.)*

TURSUN BEU — Do të mundohem përvujtërisht të vazhdoj mendimin e ndritur të Qamil beut. Në Stamboll ishit i nderuar dhe ndër të gjitha shtresat e perandorisë keni miq të shumtë, si mund të arsyetoni faktin se, duke filluar nga 1878-shi, jeni kundër nesh, gje-gjesisht kundër vetes suaj, sepse ne kemi menduar se jeni në shërbim të lartëmadhërisë së tij, padishahut. Përgjigjuni!

ABDYLI — Është e vërtetë se në Stamboll kam miq të shumë, njëri nga ata është edhe në këtë trup gjykues... Por është edhe një e vërtetë shumë më e madhe, se gjatë gjithë kësaj kohe unë nuk kam harruar se jam shqiptar, dhe si i tillë jam tash para jush. Nëse mendoni se qëndrimi në lagështirat e errëta të bodrumeve të kalasë, ka ndërruar diçka në mendimin tim, gaboni shumë.

(Tursun beu shikon Qamil beun, që i jep një shenjë që mund të vazhdojë, po në mënyrë më të drejtpërdrejtë.)

TUR SUN BEU — A mund të na thoni çka ju shtyu të organizoni qëndresën kundër Portës së Lartë?

ABDYLI — Që në fillim t'ju them: Unë nuk mund të përgjigjem vetëm në emrin tim. Jam shumë i vogël në krahasim me popullin, të cilin nuk mund ta thërritni në gjykim. Ta dënoni ashtu si do të më dënoni mua... Unë nuk kam bërë asgjë tjetër po, si bir i mirë, kam ndjekur mendimin e tij.

QAMIL BEU — Populli nuk është fajtor... Populli është emër kuptimi... Ju lutem të përgjigjeni drejt. Këtë e them për të mirën tuaj...

TUR SUN BEU — Ju lutem t'i përgjigjeni pyetjes!

ABDYLI — E thashë të vërtetën... Nuk kam bërë asgjë tjetër, pos që kam ndjekur mendimin e popullit. Ai mendim është fare i qartë. E keni ditur edhe ju, po nuk ia keni vënë veshin.

(Toni i Abdylit vjen duke u bërë gjithnjë e më i rreptë)

ABDYLI — E dini fare mirë se në tokat e perandorisë jetojnë dy milionë shqiptarë, prej të cilëve dy të tretat janë myslimanë dhe një e treta të krishterë. Për këtë ka shkruar edhe gazeta e perandorisë «Basiret». Do të thotë se këtë e ka ditur çdo njeri që di shkrim dhe lexim, mirëpo ju, pa menduar fare se si do të reagojnë banorët e këtyre trevave, dhatë pëlqimin që pjesë të tëra të vendit tonë...

TURSUN BEU — Për këtë nuk do të bisedojmë këtu!

ABDYLI — Po kjo ngjalli një indinjatë te shqiptarët. Indinjatë që më vonë u rrit në revoltë dhe mori përmasa të kryengritjes së armatosur. Këtë është dashur ta paramendoni kur nënshkruat paqen e Shën-Stefanit.

QAMIL BEU — Paqja e Shën-Stefanit nuk i takon këtij procesi gjyqësor.

ABDYLI — Çdo gjë që ka lidhje me ne është temë e procesit.

TURSUN BEU — Ju tërheq vërejtjen edhe një herë se po i bishtëroni përgjigjeve.

ABDYLI — Historia dëshmon për kontributin që populli shqiptar ka dhënë për lulëzimin e Perandorisë Osmane! Të kujtojmë vetëm Kyprylitë, sa e sa vezirë të mëdhenj, filozofë, poetë e arkitektë. Njerëz që me fuqinë e dijes së tyre ndriçuan si pishtarë në të kaluarën otomane. Pra, ne menduam se për interesat tona do të kujdeseni ashtu si ishte

dashur për shtetasit e vet... Por, me paqen e Shën-Stefanit kuptuam se ne duhet të merremi me një punë të tillë, se kurrkush nuk ta fal lirinë, se lirinë duhet vetë ta fitojmë. Me gjak.

QAMIL BEU — Do të thotë se ju, që nga paqja e Shën-Stefanit jeni në kundërshtim të hapur me Portën e Lartë. Kjo është përgjigje e saktë dhe e drejtpërdrejtë.

TURSUN BEU — A pajtoheni me këtë konkluzë që dha Qamil beu?

ABDYLI — Po, plotësisht. Po dëshiroj ta plotësoj.

TURSUN BEU — Nuk ka nevojë. Do të flisni përsëri. Më vonë.

(Tursun beu shikon procesmbajtësin, që menjëherë thërret.)

PROCESMBAJTËSI — Sulejman Vokshi!

(Ngrihet Sulejman Vokshi, nisët në drejtim të vendit ku ishte më parë Abdyl. I afrohet Tursun beu. I bën po të njëjtat pyetje.)

TURSUN BEU — Si quheni?

SULEJMANI — Sulejman.

TURSUN BEU — Llagapi?

SULEJMANI — Vokshi.

TURSUN BEU — Sa vjeç je?

SULEJMANI — 60 vjeç.

TURSUN BEU — Nga je?

SULEJMANI — Nga Gjakova, lagjia e Haxhiymerit.

TURSUN BEU — A di shkrim e lexim.

SULEJMANI — Po.

TURSUN BEU — Nënshetësia?

SULEJMANI — Jam nënshfetas i Perandorisë Osmane.

TURSUN BEU — Zanati?

(Një kohë Sulejman Vokshi nuk i përgjigjet, shikon para vetes. Tursun beu përsëri pyet.)

TURSUN BEU — Ç'zanat keni?

SULEJMANI — Luftëtar i Lirisë.

(Tursun beu shikon Qamil beun. Ai menjëherë hyn në bisedë duke i thënë procesmbajtësit.)

QAMIL BEU — Shkruaj: ministër i Mbrojtjes dhe Kryekomandant i Ushtrisë së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

(E shikon Tursun beun dhe tani ai merr fjalën.)

TURSUN BEU — Kur flitet për ju, gjithnjë nënkuptohet një njeri që është munduar të turbullojë qetësinë e perandorisë. Ju nuk njihni as miqësi, as kumbari me pjesëtarët e perandorisë. Si i tillë keni qenë i ndjekur gjithkund dhe gjithherë duke filluar nga koha e Tanzimatit dhe vitet e dyzeta. As internimet, as burgimet e shpeshta nuk ju kanë mbushur mëndjen. Edhe tash në këtë moshë të shkuar ju përsëri gjendeni para gjyqit perandorak për të njëjtat faje: Si rebel i papërmirësueshëm, që kudo që ndalet i vë flakë qetësisë sonë, si me propagandë ashtu edhe me luftime të njëpasnjëshme.

SULEJMANI — Ashtu është...

TURSUN BEU — Në procesin e hetimeve, në pyetjen që ju ka bërë gjykatësi hetues pse nuk jeni dorëzuar pas shumë kërkesave të auto-

riteteve perandorake, ju jeni përgjigjur se nuk e keni ndier veten fajtor.

SULEJMANI — Po... S'kisha pse të paraqitesha te ju. Unë përgjigjem vetëm para popullit tim. E, para tij nuk jam fajtor.

QAMIL BEU — I faleminderit zotit që në këtë bote nuk ka shumë njerëz si ti. Për zemërguresinë tënde dijmë të gjithë. Ti nuk je qorezuar as atëherë kur të është marrë djali peng dhe kur i është kërcënuar vdekja. Tash mund të them haptazi para këtyrë burrave, me dëshirë që të dëgjojë bota mbare, se një njeri që nuk ka zemër dhe s'di të kujdeset për fëmijën dhe familjen e vet ai nuk mund të kujdeset për një shtet të tërë, sikurse të ka shkuar mendja, sepse edhe shteti është një familje e madhe.

SULEJMANI — Është e vërtetë se nuk më ka rënë në mend për djalin. Këtë nuk e mohoj.

TUR SUN BEU — Si këtë përgjigje duhet t'i shikojmë të gjitha përgjigjet tuaja të mëvonshme. Jeni njeri pa ndjenja.

SULEJMANI — Më vjen mirë që mendoni kështu... Kurrë nuk kam menduar se është mirë të të lavdërojë kundërshtari. Do të thotë se ia kam arritur qëllimit meqë ju, edhe këtu në fillim të gjykimit ma dëshironi haptas vdekjen. Njohje më të mirë për mua nuk ka. *(Mexhid beu, duke dashur ta qetësojë atmosferën, e shikon Qamil beun.)*

MEXHID BEU — A më lejoni?

QAMIL BEU — Urdhëroni.

(Mexhid beu ngrihet. I afrohet Sulejman Vokshit. Në fytyrën e tij shprehet një qetësi me dëshirë që të bëjë për vete Sulejmanin.)

MEXHID BEU — E falënderoj Qamil beun që më dha mundësi edhe mua t'i bëjë pyetje një trimi siç është Sulejman Vokshi. Më vjen keq që një trim i tillë nuk ka luftuar në anën tonë, por kundër nesh. *(Pas kësaj formule të mirësjelljes, që këtë e dallon nga të tjerët, Mexhid beu nis pyetjet e veta.)*

MEXHID BEU — Zabitët e sulltanit në Pejë, në Gjakovë, në Prizren dhe në fshatrat përreth, thonë se me ju kanë pasur shumë kokëçarje gjatë kohës së reformave të Tanzimatit. Duke dashur ta di mirëfilli rrugën tuaj, më intereson aktiviteti dhe aksionet tuaja të asaj kohe.

SULEJMANI — Çka të them?

(Mexhid beu tërhiqet. I jep fjalën përsëri Tursun beut.)

TUR SUN BEU — Përshkruani sulmet që keni udhëhequr kundër nesh...

SULEJMANI — Çka të përshkruaj. Çka mund të bëjë komiti i kësaj ane, pos t'i ndihmojë ndonjë hallexhiu që ju i jeni vardisur në qafë.

TUR SUN BEU — Kush ju ka ndihmuar?

SULEJMANI — Populli.

(Për një moment mbretëron qetësia. Tursun beu e shikon Qamil beun dhe tërhiqet për një moment. Përsëri ngrihet Mexhid beu.)

MEXHID BEU — Ti je njeri i nderuar, ke tokë dhe pasuri. Ke mundur ta punosh, të jetosh me nder pa i rrahur monopatet dhe shpellat e shkreta. Çka të është dashur tërë kjo... Ti nuk je derëfikët...

SULEJMANI — Unë nuk di të flas aq mirë si ju. Luftërat e shpeshta nuk më kanë lënë ta thelloj mendimin ndër libra as t'i skalis fjalët. Di të flas vetëm troç, besoj se ju, bej i rëndë, dhe më i ri se unë, nuk do të mazin për të madhe... Mendoj se një katundar shqiptar nuk mund të ketë punë më të mirë se të luftojë për liri.

(Mexhid beu tërhiqet. Në skenë del përsëri Tursun beu.)

TURSUN BEU — Në hetimet e veprave tuaja kundër ligjit, përpos krimeve që keni bërë kundër regjimit perandorak, ju tash duhet të përgjigjeni edhe për vrasjet e Haris Mevlanit, Dervish Sutës dhe Avni Bytyçit. Për të gjitha këto ekzistojnë prova konkrete. Deklaratat e dëshmitarëve flasin se fajtori kryesor jeni ju. Avni Bytyçin e ka vrarë me dorën tënde. A i pranoni këto vepra?

SULEJMANI — Po.

(Tursun beu tërhiqet për një moment si ngadhënjyes dhe e shikon Qamil beun.)

SULEJMANI — Përpos që pranoj se ata kanë rënë qoftë nga dora ime apo e bashkëluftetarëve të mi, dua të them këtu se për këtë punë nuk e ndiej veten fajtor.

TURSUN BEU — Kjo flet se çfarë njeriu jeni.

SULEJMANI — Është e vërtetë. Por ata njerëz kanë qenë në shërbimin tuaj. Ju jeni fajtori kryesor për vdekjen e tyre.

TURSUN BEU — Ata kanë qenë njerëz të pafajshëm. Keni dashur t'i plaçkitni. Mbasi i keni vrarë, ua keni marrë kuajt.

SULEJMANI — Është e vërtetë, megjithatë kuajt nuk kanë qenë të tyre, por të perandorisë. Edhe armët ua keni dhënë ju.

TURSUN BEU — Pse i paskemi armatosur ne?

SULEJMANI — E dini ju vetë.

TURSUN BEU — Ne nuk kemi fare dijeni për këtë.

SULEJMANI — Është turp të më akuzoni për vrasje me qëllim plaçkitjeje.

TURSUN BEU — Vetë pranuat pak më parë.

SULEJMANI — Se i kam vrarë, po, edhe tash pranoj.

TURSUN BEU — Dhe iu keni marrë armët dhe kuajt?

SULEJMANI — Po, por, nuk ishin të tyre. Ua keni dhënë të dalin në mal me të vetmin qëllim: të vrasin ndonjë shokun tim, apo mua...

TURSUN BEU — Ne kërrkënd nuk kemi armatosur. Ata kanë ikur nga burgu. Kështu flasin dokumentet që kam unë para vetes.

SULEJMANI — Dëgjoni, po të kisha dashur të plackis dhe të pasurohem nuk do të dilja në mal. Në këso farë kohërash njeriu pasurohet më së miri duke ndenjur në shtëpi... Vetë e dini se çfarë pasurie do të kisha po të isha pajtuar me mënyrën tuaj të qeverisjes. Po

dëshira të luftoj regjimin tuaj është më e madhe se çdo gjë tjetër. E, sa i përket atyre, tash deklaroj para këtij gjyqi se i ka vrarë dora e popullit. Që të tre nuk kanë qenë gjë tjetër, pos vjedhës dhe vrasës. Për një punë të këtillë qenë burgosur. (Nga vendi i vet ngrihet Mexhid beu dhe u afrohet të akuzuarve.)

MEXHID BEU — (I drejtohet A. Frashërit.) A keni dëgjuar ju për këta të tre që u bë fjalë këtu?

ABDYLI — Po. Kam dëgjuar.

TUR SUN BEU — Çka mund të thoni?

ABDYLI — Se kanë qenë vrasës dhe kanë merituar një vdekje edhe më të rëndë. Më vjen keq që duhet të përgjigjem para këtij gjyqi për vepra e njerëz të tillë, për të cilët më mirë është të thuhet se kanë qenë tradhtarë të popullit shqiptar.

QAMIL BEU — Puna jonë nuk është të vlerësojmë jetën e dikujt, ajo i takon të madhit që i ka të gjithë penjtë në duart e veta.

ABDYLI — Ata kanë qenë tradhtarë.

MEXHID BEU — Doni të shtoni edhe diçka?

ABDYLI — As më pak as më shumë nga sa u thashë edhe që u tha këtu...

MEXHID BEU — Por ata janë të vdekur... Dëshiroj të di diçka më tepër se sa shkruhet në këto dokumente, të cilat mund të jenë edhe të rrejshme.

(Ndërhyt edhe Tursun beu. Mënyra se si ai flet me Mexhid beun jep të kuptosh se ia ka frikën. Mirëpo shfrytëzon rastin që, duke

*e sulmuar, të fitojë ndonjë lëvdatë nga epro-
rët e vet, ngaqë secila fjalë e tyre shkru-
het.)*

TURSUN BEU — Nëse më lejoni të them, doku-
mente të rrejshme nuk mund të ketë pa-
ra këtij gjyqi.

MEXHID BEU — Këtu gjendemi të konstatojmë
se sa të vërteta janë këto dokumente që i
kemi marrë nga shërbimi i policisë. (*Shikon
Qamil beun.*) Unë mendoj së paku kështu.

QAMIL BEU — Keni të drejtë.

*(Mexhid beu kthehet kah Abdylë dhe me bu-
tësi i thotë.)*

MEXHID BEU — Mund të vazhdoni.

ABDYLI — Kur erdha në Prizren, nuk më kujto-
het viti, Sulejman Vokshi më tha se orga-
net e policisë i kishin liruar nga burgu disa
vrasës, i kishin armatosur dhe i kishin lë-
shuar në male ku ishim ne. Më pyeti ç'men-
doja unë për këtë punë.

TURSUN BEU — E çka mendonit ju?

ABDYLI — Se ishte një provokim. Asgjë tjetër.

MEXHID BEU — Në çfarë mënyre?

ABDYLI — Sikur ata të kishin arritur ta vritnin
ndonjërin prej nesh, tërë Evropa do të dë-
gjonte për këtë punë. Ne do të shpalleshim
komitë të thjeshtë që nuk i do as populli i
tyre.

MEXHID BEU — A keni prova për një pohim të
këfillë, kur e dini se një i burgosur nuk
mund të lirohet pa dijeni të sadrazemit dhe
të sulltanit?

ABDYLI — Kjo flet më së miri, se plani për shkatërrimin tonë nuk rrodhi prej organeve të policisë së kazasë ku ishte burgu, po nga autoritetet më të larta shtetërore.

MEXHID BEU — Një akuzë të tillë nuk mund ta pranoj, meqë nuk keni prova. E të të them personalisht, as unë nuk besoj se sulltani do të interesohej për fatin e tre vrasësve. *(Tërhiqet në vendin e vet thua jse e kreu punën.)*

ABDYLI — Është e vërtetë se sulltani nuk merret me punën e tre vrasësve të shitur, po në mënyrë intensive është marrë me çështjen e fatin tonë. Këtë nuk mund ta mohoni... Gjatë viteve të vrullshme të Lidhjes, shumë pashallarë i kanë vizituar këto anë të shoqëruar me taborë të shumtë ushtarësh. A mund të thoni se për këtë nuk ka ditur sulltani?

QAMIL BEU — Mexhid beu u mundua vetëm e vetëm ta lehtësojë pozitën tuaj në këtë moment të vështirë për ju. Ai ka kërkuar leje të posaçme nga padishahu të vijë këtu, po, si duket, kot paska ardhur.

ABDYLI — Kur ia kemi filluar kësaj, nuk kemi pritur ndjesë nga askush. E nuk presim as tash. Mexhid beun e nderoj dhe e dua si shok shkolle. Tash jemi në dy anë të kundërta dhe dëshiroj të ngelë kështu. Jam i gatshëm të vazhdoj e t'u përgjigjem pyetjeve tuaja.

(Qamili e shikon. Afrohet. Diçka i thotë Mexhid beut. Ai vetëm pohon me kokë.)

QAMIL BEU — Mund të uleni.

(Pastaj shikon Tursun beun. Ai afrohet te Sulejman Vokshi me disa letra, që i merr nga tavolina dhe i drejtohet.)

TURSUN BEU — Nga dokumentet dhe nga hetimet paraprake del në shesh se për vrasjen e Mehmet Ali pashës ju jeni fajtori kryesor.

SULEJMANI — Po.

QAMIL BEU — A mund të na thoni diçka më tepër për këtë, pos një «po» shumë të thatë?

SULEJMANI — Po, mundem... Kur erdhi Mehmet Ali pasha në Prizren, të gjithë ne, që ishim anëtarë të Lidhjes, kush më shumë e kush më pak, ishim të informuar për misionin e tij në këto anë. Deri atëherë patëm shpresa të mëdha se së paku Porta nuk do të na lëshohej në shpinë. Misioni i tij ishte shumë sekret, po ne ia arritëm të kuptojmë se ai kishte ardhur të minonte nga brenda përpjekjet tona për mbrojtjen e tërësisë së tokave të banuara nga shqiptarët.

TURSUN BEU — Theksuat se misioni i tij ishte sekret, si e kuptuat atëherë qëllimin e rrugës së tij?

SULEJMANI — Me të ishte edhe një telegrafist, një njeri gjërmadhë e vërtetë që, si thonë, paradite urrente vetveten, e, pasdite, tërë botën. Çdo ditë i fyente njerëzit që rrinin në kafenenë e Marashit, duke përdorur fjalë që nuk mund të thuhesh këtu. Nga ai mësuam edhe qëllimin e vërtetë të rrugës së Mehmet Ali pashë Maxharit.

TURSUN BEU — Kush e vrau telegrafistin e pashait?

SULEJMANI — E vrau veten duke folur. Kështu e kanë këto anë. Nuk durojnë t'i prekësh në sedër.

TURSUN BEU — Kur u takuat me Myshyrin?

SULEJMANI — Të shtunën në mbrëmje.

(Tursun beu shikon letrar që ka para vetes.)

TURSUN BEU — Ishit vetëm apo ishte edhe dikush me ju?

SULEJMANI — Te Abdullah pashë Dreni isha bashkë me Ahmet efendi Koronicën.

TURSUN BEU — Si vajti biseda atë natë?

(Sulejmani mendohet çka të thotë, po ndërhyr. Qamil beu.)

QAMIL BEU — Si hyri fesati?¹⁾

SULEJMANI — Atë natë nuk hyri fesati, atë natë vetëm vazhdoi...

QAMIL BEU — Si vazhdoi? Me Mehmet Ali pashën a ishit takuar ndonjëherë më parë?

SULEJMANI — Jo. Ajo ishte hera e parë, po ne e njihnim mirë njëri-tjetrin.

QAMIL BEU — Çka u bisedua atë natë?

SULEJMANI — Ne i treguam se Lidhja nuk pajtohet me atë që kishte vendosur Porta. Nuk pajtoheshim të lëshonim pa luftë asnjë pëllëmbë tokë.

TURSUN BEU — Pastaj...

SULEJMANI — Ai kishte lidhur çykë dhe neve nuk na bënte mallë. Kërkuam të kthehej

1) grindja.

nga kishte ardhur se përndryshe do ta gjen-
te ajo që kishte gjetur telegrafistin e tij.

MEXHID BEU — A do të thotë kjo se telegrafistin
e tij e keni vrarë që t'i tërhiqnit vërejtjen
Mehmet Ali pashës?

SULEJMANI — Nuk e di, nuk merrem me punë
telegrafistësh... *(Qamil beu bën buzën në
gaz për këtë përgjigje të Sulejmanit dhe
thua jse i vjen mirë që ai iu përgjigj në këtë
mënyrë emisarit special të Portës.)*

QAMIL BEU — Deri në ç'orë ndejtët aty?

SULEJMANI — Kur kuptova se ai kurrsesi nuk
do të pajtohej me mendimin tonë, falënde-
rova të zotin e shtëpisë për mikëpritjen dhe
ika.

TURSUN BEU — A e kishit atë natë të qartë se
çka do të ndodhte?

SULEJMANI — Jo... Kisha shpresë se Abdullah
pasha do ta bindëte të hiqte dorë nga rruga
që kishte marrë pashë Maxhari... Mendoja,
më mirë e dëgjon pashai peshanë, se një
fshatar. Atë natë deri në mëngjes u përpoqa
t'i ndaloja burrat që kishin ardhur në Gja-
kovë nga të katër anët të digjnin kullën me
teshë e me koteshë. U thashë njerëzve: unë
e kam dhënë fjalën, po nuk iku nesër në
mëngjes, atëherë do ta sulmojmë.

QAMIL BEU — E kishit dhënë ju një besë të tillë?

SULEJMANI — Jo.

QAMIL BEU — Pse atëherë nuk e thatë të vërte-
tën?

SULEJMANI — Isha i bindur se atij pashai do t'i
mbushej mendja dhe të nesërmen do të ikte.

TUR SUN BEU — A e keni ditur se atë natë kishte dërguar një njeri të kërkonte ndihmë në Prizren?

SULEJMANI — Jo. Por edhe sikur ta kishim ditur kjo nuk do të çonte shumë peshë në kalendar. Kjo u vërtetua mandej. Erdhën njëmend dy kompani me ushtarë nga Prizreni, po kur e kuptuan se ku qëndronte puna, u dorëzuan... Të gjithë ishin shqiptarë.

QAMIL BEU — A jeni përpjekur edhe ndonjëherë të ndërmyjetësonit që puna të zgjidhej me të mirë?

SULEJMANI — Po. Nuk kisha dëshirë që për një Maxhar pashë të vriteshin shqiptarët mes vetit. Kot u ndërpre zjarri disa herë. Maxhar pasha mendonte se ishte i sigurt në sarajet e Drenëve. Priste aty ndihmë nga Prishtina, ndoshta edhe nga Stambolli. Të enjten, pas orës pesë, filloi lufta e tmerrshme, e cila zgjati deri në orën njëmbëdhjetë. Atëherë çdo gjë mori fund. Shumë burra u vranë për një Maxhar pashë, të cilin e kishte dërguar vetë djalli.

(Ul kokën. Duket i lodhur. Merr frymë thellë. Shikon trupin gjykses. Përsëri në gjyq mbretëron qetësia, pastaj e merr fjalën Qamil beu, i cili i drejtohet Abdyl Frashërit.)

QAMIL BEU — A keni diçka të shtoni? Dua të them, a keni qenë të informuar për këtë?

ABDYLI — Po.

QAMIL BEU — Dhe pajtoheni me një veprim të tillë?

ABDYLI — Po. Këtë punë e bëri populli. Unë pajtohem me mendimin e tij.

QAMIL BEU — Është e vërtetë se këtë punë e bëri populli, por atë e udhëhoqi dikush.

ABDYLI — Në këtë rast jo. Urdhërat që i morën ish-in urdhëra që dolën nga ndërjegjja e kombit. Çdo plak katundi, çdo kryetar familje, çdo burrë, çdo ushtar, iu bind këtij urdhëri. U bindëm edhe ne, përndryshe eshatrat tona edhe pas vdekjes, toka do të na i nxirrte jashtë. Prova më e mirë është vrasja e Abdullah pashë Drenit, njëri nga krerët më të shquar. U vra. Pse? Dyshohej se pranoi pikëpamjet e Mehmet Ali pashës në dëm të nderit dhe të dinjitetit të kombit.

MEXHID BEU — Më intereson, Abdyl, mendimi yt personal, mendoj, njerëzor lidhur me këtë vrasje mizore.

ABDYLI — Mendime personale ekzistojnë vetëm në kohë paqeje. Tash jemi në luftë. Për veprime të tilla gjendem këtu para jush. Përgjigjem vetëm në atë që lypset të përgjigjem. Sa më përket mua asnjë fjalë nuk do ta thosha para jush.

QAMIL BEU — Mund të uleni.

(Qamil beu shikon Mexhid beun dhe Tursun beun. Të gjithë me nga një të lëvizur të kokës japin shenjë pajtimi.)

QAMIL BEU — Nxirrini jashtë!

(Dy roja vijnë në drejtim të Abdyl Frashërit dhe Sulejman Vokshit. Ata ngrihen Dalin nga salla e gjyqit.)

(Errësim.)

2.

Në një divanhane të bukur të një shtëpie allaturka janë mbledhur konsujt e Italisë, Austro-Hungarisë dhe Francës. Pritet ardhja e konsullit rus. Është kjo shtëpia e konsullit italian, i cili ka organizuar këtë «Soare» për kolegët e vet. Nga ora e bukur, që gjendet në skaj të divanhanes, dëgjohej gjashtë të rrahura. Konsulli francez shikon orën e xhepit.

KONSULLI FRANCEZ — Nuk e luajka sekondin kjo orë.

KONSULLI ITALIAN — E kam kujtim nga prindërit, orë zvicerane. E punuar, si të them, enkas për familjen tonë.

KONSULLI FRANCEZ — Një orë të këtillë unë kurrë nuk do ta sorollatja këtyre anëve.

KONSULLI ITALIAN — Nuk mund të ndahem nga ajo... Më lidhin kujtime të shumta.

KONSULLI FRANCEZ — Keni të drejtë, unë e kam gabim... Njeriu gjithnjë duhet t'i ketë rreth

vetes gjërat që i do... Më duket, thatë se do të vijë edhe konsulli rus?

KONSULLI ITALIAN — Po.

KONSULLI FRANCEZ — Vajti ora gjashtë e ai nuk po duket. A thua, pse nuk erdhi?

KONSULLI ITALIAN — Nuk e di. Shpresoj se nuk i ka ndodhur gjë.

(Këtyre u afrohet konsulli austro-hungarez.)

KONSULLI AUSTRO-HUNGAREZ — Më është bënë i padurueshëm ky qytet. E ndiej veten si në burg. Kurrë nuk do të mbarojë ky gjykim i marrë! Nga kjo kasaba kurrë nuk do të iki!

KONSULLI FRANCEZ — Durim, koleg, durim.

KONSULLI AUSTRO-HUNGAREZ — Më duket se biseduat për kolegun rus?

KONSULLI ITALIAN — Po, dini diçka për të?

KONSULLI AUSTRO-HUNGAREZ — Dëgjova rastësisht, nga dragomani im... është njeri që hyn gjithkund e dëgjon shumë gjëra...

KONSULLI ITALIAN — Mos i ka ndodhur diçka?

KONSULLI AUSTRO-HUNGAREZ — Jo atij, po njërit prej spiunëve të tij. E kanë zënë dhe e kanë vranë.

KONSULLI FRANCEZ — Kush?

KONSULLI AUSTRO-HUNGAREZ — Si duket shqiptarët... Mendohet se ai kishte qenë një ndër fajtorët kryesor që u zu Sulejman Vokshi...

KONSULLI FRANCEZ — Unë nuk besoj në një punë të tillë.

KONSULLI AUSTRO-HUNGAREZ — Është e vërtetë se ata e vranë atë njeri, bile para derës së konsullatit rus. Mendoj se kjo është arsye-

- eja kryesore që nuk erdhi sonte. Ka frikë...
Del vetëm atëherë kur e lyp detyra.
- KONSULLI FRANCEZ — Mos qofsha në lëkurën e tij.
- KONSULLI AUSTRO—HUNGAREZ — Asnjëri prej nesh nuk është në pozitë më të mirë. Tash, kur shqiptarët e dinë se si u sollën qeveritë tona ndaj lutjeve, memorandumeve të tyre të shumta, mund të hakmerren.
- KONSULLI ITALIAN — Besoj se nuk mendoni seriozisht...
- KONSULLI AUSTRO—HUNGAREZ — Jo, por as nuk mahnitem... Kohë të pamira janë këto...
- KONSULLI FRANCEZ — Si po shkon puna në gjyq? Dini gjë?
- KONSULLI AUSTRO—HUNGAREZ — Pak. Tash për çdo informatë duhet të paguaj shumë më tepër se përpara, por, besoj, se edhe kjo do të kalojë.
- KONSULLI ITALIAN — Nuk keni asnjë lajm nga tërë ato lidhje me të cilat lavdëroheni, zoti konsull i Austro-hungarisë?
- KONSULLI AUSTRO—HUNGAREZ — S'është që nuk kam, po jo aq sa do të dëshiroja... Është ky një proces që duhet mbajtur në mend. Si njëri ashtu edhe tjetri në vend se të ulin bishtin dhe t'i numërojnë të rënat, sulmojnë. Akuzojnë.
- KONSULLI FRANCEZ — Të tillë janë shqiptarët.
- KONSULLI AUSTRO—HUNGAREZ — Apropos kësaj, kam dëgjuar një anekdotë në Selanik, që flet shumë mirë për karakterin e tyre. Mehmet Ali pashë Misiri, themeluesi i Egjiptit,

që ishte shqiptar i këtyre anëve, duke parë se Ali pashë Tepelena kishte probleme me suliotët, i dërgoi një letër shpottitëse. I shkroi: Si është e mundur që nuk ia del në krye me një milion shqiptarë, kurse unë i bind katërqind milionë felahë?

(*Qeshje e konsujve.*)

KONSULLI FRANCEZ — Çka iu përgjigj Tepelena pashës së Misirit?

KONSULLI AUSTRO-HUNGAREZ — Lehtë e ke pasur ti me felahë, po sikur të kishe kësi luanë shqiptarë, që secili mendon se është mbret, do të të pyetja unë atëherë.

KONSULLI ITALIAN — Është mirë të mbretërojnë ky mendim mes tyre. Sa më shumë të mendojnë kështu, aq më pak do t'u shkojë ndoresh ta nxjerrin atdheun nga balta.

KONSULLI FRANCEZ — Lidhja Shqiptare mendon se kanë forca edhe mund të bashkohen. Kjo nuk duhet harruar...

KONSULLI AUSTRO-HUNGAREZ — Po, kurrë nuk ka ditur ta përdorë për të mirën e vet.

KONSULLI FRANCEZ — Ngjarjet më të afërta na flasin se kanë filluar të mësohen e të punojnë për të mirën e vet.

KONSULLI ITALIAN — Keni të drejtë... Jo vetëm Lidhja Shqiptare e Prizrenit, po ka edhe prova të tjera se këta rebela kanë filluar të ngrihen. Shembull eklatant i kësaj është edhe Hoxhë Tahsini, rektor i Universitetit të Stambollit, nieri me të cilin mund të mburret Evropa. Tërë veprimtarinë e vet ia kush-toi çështjes kombëtare.

KONSULLI AUSTRO-HUNGAREZ — Për këtë nuk paskam dëgjuar.

KONSULLI FRANCEZ — Është diplomuar për filozofi dhe astrologji në Paris. Do të thotë se Lidhja nuk është e rastit. Është vetëm një vazhdim i mendimit liridashës që ka nisur të mëkëmbet.

(Nga jashtë dëgjohet një e trokitur në derë. Konsulli italian shikon shërbëtorin, që shpejt largohet. Të gjithë presin me kërshtëri. Më në fund në dhomën e tyre hyn konsulli rus i shoqëruar nga shërbëtori.)

KONSULLI ITALIAN — O, menduam se nuk do të vini.

KONSULLI FRANCEZ — Jeni mirë...

KONSULLI RUS — Po, ju faleminderit, kisha ca punë dhe u vonova.

KONSULLI AUSTRO-HUNGAREZ — Ne u frikësuam se mos ju ka ndodhur diçka, pas akcidentit me atë njeri para portës suaj...

KONSULLI RUS — Ah, po asgjë me rëndësi.

KONSULLI ITALIAN — Mund të servojmë pijet?

KONSULLI RUS — Sa më përket mua, vetëm urdhëroni.

(Konsulli italian shikon shërbëtorin. Ai me të shpejtë humb pas një këndi dhe pas pak kohe del me një tabaka të madhe në dorë, ku gjenden të vendosura gotat me pije. Hyn mes tyre. Secili merr nga një gotë. Sekuenca përfundon me cakrimin e gotave.)

3.

BURGU I KALASE

(Nëpër korridorin e burgut kalon roja. Në duar ka dy enë me ushqim. Hap dritaren që është në derën e vogël dhe lë një-rën nga enët, bën pastaj edhe disa hapa dhe në derën tjetër përsëri hap dritaren e vogël, vëren Abdylin si rri afër dritares duke shikuar qiellin. Abdylit ndien se u hap dritarja. E sheh rojen. Pastaj dëgjohej hapja e rëndë e derës, prangat e Abdylit dhe roja që hyn. E lë enën mbi tavolinën e vogël të punuar nga dërrasat e vrazhda që gjatë përdorimit të shumtë kanë zënë të latuar. Roja afrohet. Ia zgjidh prangat Abdylit. Në fytyrën e tij vërehet një ndjenjë turpi. Më në fund nuk i durohet edhe thotë.)

ROJA — Abdyl efendi, më vjen keq që më duhet të të lidh çdo ditë. Po, kam gjashtë fëmijë...

Pastaj, nëse unë nuk e bëj këtë punë, e bën tjetri.

ABDYLI — Mos më zgjidh as tash. Mund të ha edhe me duar të lidhura.

ROJA — Jo, tash jam unë këtu. Të lutem, bëma hallall. Edhe unë jam shqiptar. Kujt ia lidh duart, po më vjen shumë turp... Ani kush?. Unë... kurrkushi, prijësit si ty...

ABDYLI — Është punë edhe kjo, punë e nder-shme.

(Abdyli nis të hajë. Roja ngrihet. I sjell vedrën e vogël me ujë.)

ROJA — Është e ndaluar të rri kështu. Po... kujt i durohet pa hyrë dhe pa ndërruar ndonjë fjalë me zotërinë tuaj?

(Abdyli ha. Nuk flet. Në atë qetësi dëgjohet edhe më fort zëri i pikëllueshëm i një të burgosuri. Vjen si jehonë diku nga fundi i korridorit. Herë pas here dëgjohej fjalët e këngës që këndon ai.)

«Mbetsh, more shokë, mbetsh,
përtej Urës së Qabesë
falni me shëndet nënesë...
...Të dy qetë e zez t'i shesë
e t'i japë nigja së resë...
...Të më shesë kalin
të më rrisë djalin...
...Të më shesë mushkën
të më rrisë çupën...
...Nëse pyet nëna për mua,
i thoni që jam martuar...
Nëse pyet ç'nuse mori

tri plumba në krahruar.
...Nëse të pyet se në ç'kal hipi,
në dy-tri dhoga meiti...
Nëse pyet se ç'krushq i vanë,
zhgabat dhe sorrat e hanë.

(Kjo këngë dëgjohet që nga fillimi, herë pas here edhe gjatë skenës së rojes me Abdyl Frashërin.)

ABDYLI — Kush është ky që këndon gjithnjë?
ROJA — Djalë hasreti. I dënuar me varje se nuk ka dashur të shkojë nizam. Vetëm këndon, thua se nuk do të varet nesër në mëngjes. E kam njohur babën e tij. Është vrarë në luftërat me Dervish pashën, diku kah Carnaleva. Ka qenë luftëtar i Micit, Mic Sokolli. Flakë jo burrë, edhe djali ia ka këputë kryet.

ABDYLI — Njeriu më lehtë e përqafoi vdekjen, nëse nuk mendon për të.

(Përsëri nga larg dëgjohet kënga e të burgosurit. Roja flet me një rezignim për ngjarjet që i përjetuar në ditët e fundit.)

ROJA — Dje kanë varur pesë. Sa ishit ju në gjyq. Të rinj shtalb, fytyrës brisk pa i rënë. Sot do të ishin gjallë, sikur të mos i kishte tradhtuar një fqinj i tyre.

(Përsëri dëgjohet kënga si ta sillte era nëpër korridore, ushtueshëm.) Zoti Abdyl... Shqiptari ka vuajtur gjithmonë për mend, nuk di të ruhet, si mikut si armikut ia hap zemrën... E, zemra është zemër, zotrote,

nuk është lakër. I shoh unë eprorët e mi. Kur duan të arrijnë diçka, që nuk arrihet me dhunë... lyhen e stërlyhen derisa të futen në zemër. Pastaj, ashtu, si gjarpër, cap e ti i vdekur në vend. Të më falni, ndoshta shumë fola po, njerëz si ju kushedi a do të më mbërrijë ymri të takoj.

ABDYLI — Mos guxo ta humbasësh shpresën në njerëzit tanë... popullin tënd... Jemi populli i vogël në këtë botë të madhe pa miq e mos u habit aspak që zemrën e mbajmë në dorë. Çdo gjë me gjak e kemi fituar dhe me gjak duhet ta fitojmë. Ta dish, se prej gjakut të të pafajshmëve, të atyre të djeshmëve dhe atyre të nesërmeve, do të vijin ditë të lumtura. Këtë kurrë nuk duhet ta harrosh. Shumë shehit ka rritur ky popull dhe do të rrisë.

(Nga xhamia e Sinan pashës dëgjohe zëri i hoxhës. I përcjell nga era vjen si diçka ireale.)

ROJA — Jacija...

(E thotë këtë fjalë pa menduar se ç'po thotë, i tretur në mendime të ngjallura nga ajo që tha Abdylit. Djaloshi, që këndonte, nuk dëgjohe më. Dëgjohe vetëm zëri i hoxhës. Abdylit ka ngrënë. I afrohet rojes, që me turp i ven prangat. Ai, duke u larguar nga qelia e tij, kthehet edhe një herë kah Abdylit.)

ROJA — Ama, bëma hallall për këto pranga...
(Abdylit nuk i përgjigjet, vetëm i buzëqesh lehtë. Ai tërhiqet me një respekt ndaj tij,

mbyll derën me çelës. Dëgjohen hapat e tij duke u larguar. Qetësi, ezani i hoxhës vjen nga larg si nga një botë tjetër. Abdyli është mbështetur për muri afër dritares. Mbi kokë të tij gjendet një pishë e ndezur, që më tepër tymon se sa bën dritë.)

4.

DIVANHANIA E KONSUJVE

Atmosferë e gëzuar. Nga dritarja e tyre e hapur dëgjohet ezani i hoxhës. Me gotë në dorë pranë dritares është konsulli francez, dëgjon ezanin dhe pastaj u kthehet kolegëve të vet.

KONSULLI AUSTRO-HUNGAREZ – Governat turke është si qen i zgjebosur. Po ta trembësh e të ikësh, të lyhet pas, po ta shikosh pak në sy, si e shikuan këta, s'gjen vrimë ku të futet, ani prej kujt se, prej një grushti kryengritësish.

(Qeshje e të gjithëve, thujse mezi pritën një fjalë të tillë të kolegut të tyre. Ai vazhdon.)

KONSULLI AUSTRO-HUNGAREZ – Unë shqiptarët i kam kuptuar posa arrita këtu. E dini? Në Vjenë kam qenë i dashuruar me Furienë, filozofin tuaj dhe filozofinë e tij. Me të ardhur këtu i kam kuptuar edhe më mirë teoritë e tij mbi historinë e shoqërisë nje-

rëzore. Sipas ndarjes së Furiesë, shqiptarët do të ishin mes shkallës së barbarisë dhe patriarkatit.

(Duke folur në këtë mënyrë, ai i afrohet grupit të konsujve dhe në mënyrë decisive i drejtohet konsullit rus.)

KONSULLI AUSTRO-HUNGAREZ — Ç'thoni ju për këtë, zoti konsull i Rosisë?

KONSULLI RUS — Më falni... unë nuk merrem me teori shkencore...

KONSULLI AUSTRO-HUNGAREZ — Nuk ju pyeta kot, ju lutem. Në shtypin rus dhe në periodikët shkencorë është shkruar mjaft për shqiptarët, bile-bile janë zhvilluar edhe polemika për ta. Më kujtohet një artikull ku thuhet se, në rrethin e Dibrës shqiptarët ecin lakuriq dhe jetojnë ashtu, dua të them, si në komunitetin primitiv. Burrat nuk dinë kë kanë grua, gratë nuk dinë kë kanë burrë. Kështu, disi...

KONSULLI RUS — Më falni, unë nuk i kam lexuar këta artikuj...

KONSULLI AUSTRO-HUNGAREZ — Ju lutem! Mos më lerni kështu... Nuk gënjej... Njëmend i kam lexuar këto në shtypin rus. Kam pirë pak se do të më kuitohej autori. Çka mendoni ju? Para se të vija konsull i Austro-Hungarisë në këto anë, iam interesuar të lexoi cdo gjë që ka të bëjë me këtë popull.

KONSULLI FRANCEZ — Keni të drejtë, edhe unë kam lexuar gjëra të tilla, bile edhe marri të tiera, se ata nuk jetojnë nëpër shtëpi po nëpër drunj.

- KONSULLI RUS — Nuk është e mundur t'i keni lexuar të gjitha këto në shtypin rus.
- KONSULLI FRANCEZ — Nuk më kujtohet se a ka qenë gazetë ruse apo diçka tjetër, por është e vërtetë se i kam lexuar.
- KONSULLI AUSTRO-HUNGAREZ — E shikoni. Menduat se ju gënjej?
- KONSULLI ITALIAN — Ju lutem, hiquni atyre fjalëve. Nuk jemi mbledhur këtu të fjalosemi për shqiptarët. Kemi punë më të mënçura.
- KONSULLI FRANCEZ — Nuk është puna e shqiptarëve, por e principeve. Apo jo?
- KONSULLI AUSTRO-HUNGAREZ — Natyrisht... Ju lutem, nuk keni arsye të fyheni, po duhet të pranoni se atë që mund ta gjejë njeriu në shtypin rus, nuk e gjen kund në botë.
(*Konsulli italian i afrohet konsullit rus, mundohet ta qetësojë që të mos i marrë seriozisht fjalët e kolegut francez.*)
- KONSULLI ITALIAN — Ju lutem, jemi mbledhur të argëtohem. Nuk i kemi të shpeshta netët e këtilla. Prandaj të mos diskutojmë me kaq ngulm për gjëra që nuk na interesojnë shumë. Ta çojmë edhe nga një gotë për një mirëkuptim më të madh mes nesh.
(*Ata e pijnë edhe nga një gotë. Tash në bisedë inkluadrohet konsulli rus.*)
- KONSULLI RUS — Duke ndenjtur gjatë mes tyre kemi nisur t'i marrim adetet dhe sjelljet e tyre. Duhet ikur sa më parë nga ky vend i mallkuar.

(Konsulli italian i afrohet konsullit austro-hungarez, për të cilin mendon se është i dehur.)

KONSULLI ITALIAN — Dëshironi një kafe?

KONSULLI AUSTRO-HUNGAREZ — Nuk ka nevojë... Mirë jam...

KONSULLI ITALIAN — Mos t'ju vijë keq. E kam të Jemenit... gjë e rrallë në këtë kohë.

KONSULLI AUSTRO-HUNGAREZ — Ju faleminderit, njëmend ju faleminderit! Nuk keni përse të shqetësoheni.

(Në anën tjetër konsullit francez i afrohet konsulli rus.)

KONSULLI RUS — Koleg, nëse më lejoni të vëneroj, keni harxhuar shumë para nga arka e konsullatës frënge për t'i blerë prijësit e Lidhjes.

KONSULLI FRANCEZ — Unë... Paskeni informata të gabuara... Kontaktet e mia kanë qenë vetëm me popullsinë e thjeshtë, mendoj kam kontaktuar ashtu, sa për vete...

KONSULLI RUS — Gjërat që dihen nuk keni nevojë t'i fshihni. Kësaj radhe ju ka ndodhur juve, që nuk keni mundur t'i bleni prijësat shqiptarë, herën tjetër, ndoshta, na ndodh neve. S'ka këtu kurrfarë turpi. Gabime konsullare në vlerësimin e situatës kanë ndodhur dhe do të ndodhin; janë pjesë përbërëse e praktikës sonë të përditshme. Por, një gjë nuk e kam të qartë. Çka ju duhen ata, prijësa të vegjël të një populli të vogël?

KONSULLI ITALIAN — Atë që jeni munduar ju me të holla, e nuk ia dolët në krye, po e

bëjnë priftërit franceskanë në tërë viset e Veriut.

KONSULLI FRANCEZ — T'i përgjigjem, pra, pyetjes suaj pse kemi dashur t'i blejmë prijësit e vegjël të këtij populli... Të parafrazoj vetëm një mendim të konsullit anglez në Selanik, Blantit, që na tha para se të nisesha këndeje. Populli shqiptar është element që nuk duhet të lihet anash në çfarëdo kombinim të ardhshëm politik. Nëse për asgjë tjetër, duhet pasur parasysh bile krijimin e një krahine unike shqiptare.

KONSULLI ITALIAN — Njëmend mendoni kështu?

KONSULLI FRANCEZ — Jam i bindur. Është popull që dallon nga popujt e tjerë të Ballkanit. Lufton kaq gjatë kundër turkut pushtues e ndoshta do të luftojnë edhe kundër pushtuesve të tjerë.

(Hyn në bisedë edhe konsulli austro-hungarez.)

KONSULLI AUSTRO-HUNGAREZ — Çfarë janë, do të luftojnë edhe kundër pushtetit të vet... Laus, barbar...

(Kurrkush prej të pranishmëve nuk i vë veshin. Dëgjojnë mendimet e konsullit të Francës.)

KONSULLI FRANCEZ — Mendoj se qëndrimi inioues i Bismarkut në Kongresin e Berlinit ndaj çështjes shqiptare dashur padashur, i ka larguar ata nga Evropa aq shumë sa edhe në të ardhmen ata do të na shikojnë gjithmonë si armiq.

KONSULLI ITALIAN — Nuk duhen marrë kaq me seriozitet punët e tyre. Janë popull që për nga numri nuk çojnë shumë në kandin e politikës evropiane.

KONSULLI FRANCEZ — Nuk do të thoshja kështu. Kurrë nuk duhet shikuar madhësi e një populli, po pozita strategjike e tij.

KONSULLI RUS — Një shtet të vogël, në çfarëdo kohe mund ta pushtosh.

KONSULLI AUSTRO-HUNGAREZ — Njëmend është kafshatë e lehtë, por e lakmon secili nga ne aq shumë, sa mund të na shtyjë të konfrontohemi dhe të grindemi mes veti.

KONSULLI ITALIAN — E, si e shihni ju, pra, zgjidhjen?

KONSULLI AUSTRO-HUNGAREZ — Ashtu si e shohin priftërit françeskanë dhe Selia e Shenjtë nga Italia juaj. Duhet t'i bëjmë për vete, ashtu që ata vetë të kërkojnë ndihmën tonë, të ndonjërit nga ne. Atëherë lufta mes nesh për këtë copë vend është e pa kuptimtë. Ai që do të mund të përfitojë besimin e tyre, prezencën e vet në këtë vend do ta arsyetonte me lidhjet e forta tradicionale miqësore.

KONSULLI ITALIAN — Teoria juaj nuk është aq e pa kuptimtë.

KONSULLI FRANCEZ — E, me çka mund të lavdërohet Evropa kur është fjala për shqiptarët? Me asgjë. Gjykimi i prijësve të Lidhjes është, sipas mendjes sime, edhe gjykim i ndërhyrjes sonë kundër këtij vendi dhe kundër tyre.

5.

SALLA E GJYQIT

Gjyqi nuk ka ndërruar asgjë nga seanca e mëparme, pos që në këtë seancë pjesëmarrja e Qamil beut është e reduktuar maksimalisht.

QAMIL BEU — Ajo që habit këtë gjyq është fakti se një njeri si ju, që studimet e larta i kreu në Stamboll, që ishte deputet në parlamentin turk, njeri i nderuar, kahdo që jeni sjellë keni punuar prapa shpinës tonë me të vetmin qëllim ta rrëzoni qeverinë otomane.

TURSUN BEU — Në Komitetin Qendror për Mbrojtjen e të Drejtave të Kombësisë Shqiptare, që u formua në Stamboll në vitin 1877, krahas Pashko Vasës, Sami Frashërit, ju lozët një rol vendimtar. Pra, lirisht mund të thuhet se jeni fajtori kryesor për të gjitha trazirat e mëvonshme që buruan nga Lidhja e Prizrenit. A e pranoni këtë faj mbi vete?

ABDYLI — Këtë nuk e kuptoj si faj, po si detyrë ndaj popullit tim. Do të jem i lumtur po qe se e nesërmja këtë punën time e çmon si të suksesshme. Nëse këtë ju e çmoni si faj, atëherë e pranoj.

TURUN BEU — A është e vërtetë se gjatë muajve prill-qershor të vitit 1879 ndër morët udhëtime në shtete të ndryshme të Evropës për të ndikuar në opinionin botëror në të mirën e çështjes shqiptare?

ABDYLI — Po.

TURUN BEU — A pranoni se gjatë këtij udhëtimi, si kryetar delegacioni, keni vizituar Vjenën, Berlinin, Parisin dhe Romën?

ABDYLI — E pranoj.

TURUN BEU — Dhe gjithkund keni mbajtur fjalime, keni shkruar memorandume drejtuar Fuqive të Mëdha që të rishikojnë mundësitë që çështja shqiptare të zgjidhet në mënyrë të drejtë.

ABDYLI — Harruat të theksoni edhe kontaktet që kemi pasur me njerëz të shquar të këtyre vendeve.

TURUN BEU — Pas të gjitha këtyre pranimeve, ju lutem, si mund të mohoni se Lidhja e Prizrenit nuk ishte e lidhur me fuqitë e Perëndimit dhe se nuk iu ka shërbyer atyre si agjenturë?

ABDYLI — Këtë e kam mohuar edhe në procesin e hetimeve. E mohoj edhe tash. Një mendim të këfillë e ka përhapur Dervish pasha, por, si e dini edhe ju vetë, nuk pat sukses. Kërkesat tona për pavarësi i çmoi si dëshirën

tonë për t'u futur nën pelerinën e Papës. Është e vërtetë se shqiptarët janë edhe myslimanë edhe katolikë edhe ortodoksë. Por fetë e ndryshme nuk janë karakteristike për kombin tonë, përkundrazi.

TUR SUN BEU — A keni prova se nuk keni qenë agjenturë e Perëndimit?

ABDYLI — Kuptohet.

TUR SUN BEU — Jam kureshtar t'i dëgjoj provat tuaja.

ABDYLI — Realiteti.

TUR SUN BEU — Faktet e realitetit flasin ndryshe...
(Afrohet te tavolina e vet dhe nis të lexojë një letër.)

TUR SUN BEU — Më 7 maj një delegacion i Lidhjes Shqiptare në qytetin e Romës, në Itali, në kafenenë «Ultima Volta» u takua me Xhuzeppe Garibaldin. Sipas shënimeve që kam këtu përpara, grupin e keni udhëhequr ju.

ABDYLI — Këto që thatë nuk flasin për një lidhje me Perëndimin.

TUR SUN BEU — Të përfundoj. Në atë kafene keni biseduar për çështje që kanë të bëjnë me sigurinë territoriale dhe politike të shtetit të ardhshëm shqiptar. Është e vërtetë një gjë e tillë?

(Abdyli mendohet për një moment.)

ABDYLI — Nëse mund të merret...

(Ndalet shikon të pranishmit.)

TUR SUN BEU — Vazhdoni.

ABDYLI — Jo, nuk është e vërtetë ajo që thatë.

TUR SUN BEU — Ju lutem, thërrisni dëshmitarin e parë.

(Roja përshëndet dhe shpejt humb.)

TURSUN BEU — Dëshiroj ta njoftoj gjyqin se asnjë pikë nga aktakuza nuk është pa dëshmitarë. Deri tash nuk i thirrëm, ngase nuk pat nevojë.

(Roja kthehet dhe përsëri përshëndet.)

TURSUN BEU — Le të hyjë.

(Hyn një njeri i veshur evropiançe.)

TURSUN BEU — Jeni musliman apo i krishterë?

DËSHMITARI — Musliman.

TURSUN BEU — E njihni këtë njeri që është këtu para jush?

DËSHMITARI — Po. Është Abdyl bej Frashëri.

TURSUN BEU — Për herë të parë po e shihni tash, apo e keni parë edhe më parë?

DËSHMITARI — E kam parë edhe përpara.

TURSUN BEU — Ku? Ku ju lutem? Na thoni vendin dhe ditën.

DËSHMITARI — E kam parë disa herë.

(Tash ndërhyt për herë të parë edhe Mexhid beu.)

MEXHID BEU — Me çka merreni, çfarë zanati keni?

DËSHMITARI — Kam një përfaqësi tregtare në Trieste dhe një dyqan me halija¹⁾ në Romë.

(Tursun beu shikon Qamil beun dhe ky i kthehet Mexhid beut. I flet me të butë.)

QAMIL BEU — Nuk jeni i kënaqur me pyetjet e Tursun beut?

MEXHID BEU — Jo, i kënaqur jam.

QAMIL BEU — Atëherë lëreni të vazhdojë.

1) sixhade

(I jep shenjë me krye Tursun beut që të vazhdojë.)

TUR SUN BEU — Na tregoni kur e keni parë Abdyl Frashërin dhe ku?

DËSHMITARI — E kam takuar një herë në Trieste...

TUR SUN BEU — Keni biseduar me të apo vetëm e keni parë?

DËSHMITARI — Kam biseduar... Bej efendiu interesohej shumë për lidhjet ekonomike që kishin viset shqiptare me Italinë dhe Austrinë.

TUR SUN BEU — Për çka biseduat tjetër?

DËSHMITARI — Unë i tregova se ato lidhje do të mund të rriteshin nëse do të kishte kontakte më të shpeshta me njerëzit zulmëmëdhenj të kësaj ane të botës.

TUR SUN BEU — A ju tha diçka Abdyl Frashëri?

DËSHMITARI — Po. Më kujtohet shumë mirë kur tha: Kështu nuk do të shkojë gjatë, se ekonomia e vendit do të lulëzojë, se më nuk do të kemi ndërmjetësues Portën e Lartë, po lidhjet do të jenë të drejtpërdrejta.

TUR SUN BEU — Si reaguat ndaj këtyre fjalëve të tij?

DËSHMITARI — Më frikuan pa masë, po nuk pata guxim t'i kundërvihesha, se e dija që ishte deputet në parlamentin turk.

(Pastaj Tursun beu i kthehet Abdyl Frashërit. E shikon një herë në mënyrë triumfale.)

TUR SUN BEU — Është e vërtetë kjo që tha dëshmitari?

ABDYLI — Po, asnjë fjalë nuk ka gënjyer. Vetëm

habitem si ka mundur t'i mbajë mend të gjitha.

TURSUN BEU — Ju faleminderit! (*I kthehet përsëri dëshmitarit.*) Thatë se e keni takuar edhe një herë Abdyl Frashërin. A mund të na thoni ku dhe kur?

DËSHMITARI — Po. Në Romë, në kafën «Ultima Volta», më 7 maj 1879.

MEXHID BEU — Si e mbani mend kaq mirë datën?

DËSHMITARI — Atë ditë festonim hapjen e një përfaqësie të re në Romë.

TURSUN BEU — Me kë ishte Abdyl Frashëri në kafe?

DËSHMITARI — Me njëfarë Garibaldi.
(*Tash ndërhyt edhe Abdyl.*)

ABDYLI — Për këtë nuk keni pasur nevojë ta mundoni dëshmitarin. Vetë jua thashë të gjitha.

(*Tursun beu shikon Qamil beun.*)

QAMIL BEU — Për herë të fundit ju tërheq vërejtjen që të mos ndërhyt dhe të mos flisni pa ju pyetur.

TURSUN BEU — Për çka bisedonin këta dy burra?

DËSHMITARI — Garibaldi tha se shqiptarët kanë armik kryesor Austro-Hungarinë. Vend që dita-ditës po zgjerohet. Dëshira e tyre e flakët është të dalin në detin Adriatik e aq më shumë në dyert e Otrantit, atëherë do të kishte në dorë Italinë dhe shumë shtete të tjera.

TURSUN BEU — Si iu përgjigj Abdyl Frashëri?

DËSHMITARI — Jo, tha ai, shqiptarët armikun krye-

sor kanë otomanin dhe se atë së shpejti do ta heqin nga shpina, vetëm i duhet ndihma e shteteve të Evropës Perëndimore. Edhe këtë ndihmë shqiptarëve do t'ua sigurojnë.

TURSUN BEU — Ju faleminderit! Mund të shkoni. *(Para se të largohet ai, Mexhid beu e ndal me fjalë.)*

MEXHID BEU — A mund të bëni be në zot dhe në dyzet qitape se këto që thatë janë të vërteta?

DËSHMITARI — Bëj be.

MEXHID BEU — Mund të shkoni.

TURSUN BEU — Çka mund të thoni tash?

ABDYLI — Kjo që tha dëshmitari në fund nuk ishte e vërtetë.

TURSUN BEU — Sipas jush, si është e vërteta?

ABDYLI — Atë që tha dëshmitari për Garibaldin, fjalët e tij lidhur me Austro-Hungarinë, ishin të vërteta. Unë njëmend i kundërshtova sa i përket Austro-Hungarisë, po nuk fola gjë për Turqinë.

TURSUN BEU — E, çka na paskeni thënë ju? Nëse është e mundur të dimë? *(Këtë pyetje e bën me një ironi të thellë.)*

ABDYLI — Ne kurrë nuk i kemi emërtuar armiq-të, meqë numri i tyre është i madh. Pra, e them dhe tash se rreziku më i madh viseve shqiptare u kanoset nga shtetet që kanë aspirata pushtuese ndaj territoreve të tyre. Edhe tash nuk po e them se cilat janë ato e nuk e kam thënë as në bisedë me Garibaldin.

TURSUN BEU — Kur keni biseduar me Garibaldin

sigurisht keni menduar se Porta e Lartë nuk është në gjendje t'ju bjerë në fije, po, si po e shihni, keni gabuar shumë. Ne e dimë se atë ditë me Garibaldin keni biseduar edhe për çështjen e kufijve shqiptaro-grekë. E mohoni edhe këtë?

ABDYLI — Jo, këtë nuk e mohoj.

TURSUN BEU — Na thoni disa detaje nga kjo bisedë. Gjyqit i intereson kjo.

ABDYLI — Garibaldi u kishte besuar disave që nëpër Evropë përhapnin lajme se shqiptarët do të luftojnë gjer në pikën e fundit të gjakut të tyre kundër grekëve. I thashë edhe Garibaldit, si po ju them edhe juve, se ne nuk pajtohemi që administrata turke lejon hapjen e shkollave greke në Shqipërinë e Jugut. Kjo do të thotë përkrahje e hapët e shkombëtarizimit të popullsisë shqiptare në ato vise. Ne këtë e luftojmë, sepse shqiptarët kurrë nuk do të kenë pretendime territoriale ndaj shteteve fqinje. Një mendim të kundërt nga ky që thashë tashti, që është mendimi yni, e mbjellin Fuqitë e Mëdha, duke dashur të na përçajjnë me fqinjët, në mënyrë që më vonë të sundojnë më lehtë. Kjo është e vërteta e bisedës sime me Garibaldin dhe asgjë tjetër... *(Tursun beu shikon Qamil beun. Ky i jep shenjë se don ta pyesë. Shikon letrat që ka para vetes, pa shikuar as Abdylin as Sulejmanin, thotë.)*

QAMIL BEU — Se jeni treguar bukëpërmbysës ndaj Portës së Lartë, këtë nuk e luajnë as topat e Ak Hisarit. Dëshirën tuaj, Abdyl

efendi, të bashkoni toskët dhe gegët, vetë sulltani e ka përkrahur. Bile, sa mund të di, për punë që do të bënit në të mirë të Portës, natyrisht u është premtuar një post shumë i lartë, po ju u ratë me shqelm të gjithave dhe deshët pavarësi të plotë. Këtë mund ta bëjë vetëm një dinsëz, siç jeni ju.

(Duke dashur të qetësojë situatën, në bisedë futet edhe Mexhid beu.)

MEXHID BEU — Armiqtë e Portës, e të atillë nuk ka pak në Evropën e krishterë, thonë se Lidhja e Prizrenit ishte një manovër e diplomacisë turke. Këtë ata e thonë me të vetmin qëllim të fshehin prezencën e vet në të dhe t'i arsyetojnë sulmet që bëjnë kundër nesh...

ABDYLI — Mexhid bej, kam konsiderata shoqërore ndaj jush, po këto që po thoni tash, unë i mohova me fakte pak më parë.

TURSUN BEU — Ne nuk dëgjuam prova konkrete.

ABDYLI — Se Lidhja nuk ishte as manovër e diplomacisë turke, as agjenturë e shteteve të Evropës së Perëndimit, flasin proceset nga mbledhjet e Lidhjes. Do të ishte mirë t'i shfletoni ato...

QAMIL BEU — Proceset i kemi, dëshirojmë të dëgjojmë fjalë të gjalla nga ju.

ABDYLI — Mirë, dëgjoni...

6.

MBLEDHJA E LIDHJES

Burrat janë ulur në vendet e tyre. Mes tyre ndihet një gjallëri më e madhe se sa është dashur të mbretërojë në tubime të këntilla. Mes prijësave fshatarë dhe qytetarë janë të pranishëm dhe Sulejman Vokshi, Shaib Spahiu, Ymer Prizreni, Jonuz Zahdi dhe të tjerë. Mbledhjen e kryeson Abdyl Frashëri.

ABDYLI — Burra shqiptarë, vëllezër!
(Zhurma nis të qetësohet.)

ABDYLI — Nuk i ndihmojmë kësaj mbledhjeje duke ngritur zërin...

SHAIB SPAHIU — Po, të mirret Shkupi kështu, në mashtrim, këtë kurrkush nuk e ka pritur.

ABDYLI — Kjo duhet të na shërbejë si një mësim i hidhur. Para nesh është Dervish pasha. Xhelati më i madh i Perandorisë Osma-

ne. Është dinak, trim dhe diplomat, i ka të gjitha vetitë që nuk do të doja t'i ketë një armiku ynë. Po sa më parë që kuptojmë fuqinë e armikut, aq më shpejt duhet të gatiemi. Për mbrojtjen e kësaj ane do t'ju flasë Sulejmani.

SULEJMANI — Vëllezër, ditët që po afrohen nuk janë si ato të parat. Duhet të dimë njëherë e përgjithmonë se armiku që është para nesh, kësaj radhe është më i tërbuar se kurë më parë. Fitorja e tyre në Shkup, juve bashkë me mua, na shqetësoi shumë, e armikut tonë, Dervish pashës i dha zemër dhe shpresë se të gjitha qytetet e çliruara nga forcat tona do t'i fusë sërish nën flamurin osman. Një shpresë e tillë iu duhet shumë. Ata, tash, luftojnë për fytyrë. Mos t'ju duket çudi, por unë mendoj se mu kështu është, fytyrën e humbur në luftërat me shtetet e mëdha të Evropës mundohen ta zbardhin këtu, në luftën e pabarabartë me ne.

YMER PRIZRENI — Po, Sulo, po, por mos harro se edhe me ne ajo e humbi fytyrën, jo pak herë me bisht ndër vegë iku prej këndeje.

SULEJMANI — O Ymer Prizreni, ta dish se kjo është një arsye më shumë që Dervish pashai të luftojë deri në pikën e fundit. Shokë, jemi mbledhur këtu jo të lavdërohemi me fitoret e shkuara, po të pleqërojmë, të gjithë së bashku, se cila është mënyra më e mirë e mbrojtjes nga rrebeshi që po na vardiset.

SHAIB SPAHIU — Mendoj se një ndër detyrat e para është, të mblidhemi ngushtë e më ngushtë

të rreth Lidhjes sonë, në mënyrë që të mos i lejojë armikut të hyjë brenda nesh e të na asgjësojë. Rasti me Shkupin flet më së miri se një syçeletësi e tillë duhet të na prijë në çdo hap. Kur është fjala për mbrojtjen nga Dervish pasha unë pajtohem me atë që do të shtrojë Sulejmani. Por, unë do të kërkoj nga ky tubim të vendoset që, përpos ushtrisë së rregullt, në secilën shtëpi, që nuk ka mbrojtje meshkujsh, të caktohet nga një vullnetar.

SULEJMANI — Mirë e pat Shaibi, duhet të ruhem i që në radhët tona të mos depërtojë armiku, se atëherë s'ka gjë që na shpëton. Sa për atë, secilës shtëpi t'ia caktojmë nga një vullnetar, besoj se është fjalë me vend, po për këto punë të bisedojmë më vonë. Tash do të doja të më jepni pëlqimin për një mobilizim të të gjithëve duke nisur nga mosha 15-vjeçare e duke përfunduar në ato 70 vjeç. Vetëm në këtë mënyrë do të mund të grumbullojmë një fuqi që për afërsisht do të ishte në gjendje të përleshet me ushtrinë e Dervish pashës, që ka afro njëqind mijë ushtarë të armatosur më së miri.

(Në mbledhje mbretëron qetësia. Më në fund fjalën e merr Abdylë.)

ABDYLI — Burra, fuqia e armikut nuk na ka frikësuar kurrë e nuk do të na frikësojë as tash. Ne kemi për çka të luftojmë. Mbrojmë varrezat e të parëve, tokat tona. Mbrojmë rritjen e qetë të brezave të ardhshëm. Për këtë secili prej nesh ka nder të vdesë në

fushëbetejë. Po, të them edhe këtë, prej nesh nuk kërkohet të vdesim, po më tepër, të mbrojmë këtë vend që kurrkujt nuk ia zë rrugën.

YMER PRIZRENI — Të gjithë të mëdhenjtë na kthyen shpinën, edhe Lindja edhe Perëndimi. Kjo nuk po më frikëson. Sa më parë që të kuptojmë se jemi vetëm aq më mirë do të mbrohemi. Një frikë të vetme e kam: a do të mund të tubojmë një ushtri kaq të madhe për një kohë kaq të shkurtër.

SULEJMANI — Na duhet, patjetër...

YMER PRIZRENI — Po edhe nëse e tubojmë, si ta ushqejmë krejt atë forcë të mbledhur në një vend? Deri tash kishim mundësi t'i jepnim secilit ushtar vetë 300 derhem bukë e edhe tash e tutje mund të japim aq... A mjafton... Nuk e di... po ju lë juve të vendosni.

JONUZ ZAHDI — Pse të mbledhim ushtri. Gjithmonë jemi mbrojtur nga bajraçet. Ushtrinë e ka ushqyer katundi dhe ajo e ka mbrojtur katundin e vet. Në këtë mënyrë nuk jemi të detyruar të kujdesemi për ushqimin e saj. Për këtë punë do të kujdesen fshatrat. Edhe pa këtë mobilizim ne i çliruam shumë qyte. Nuk dëshiroj t'i kundërvihem mendimit tënd po, si u tha, ushtria e madhe kërkon ushqim të rregullt, kërkon njësi që kujdesen vetëm për këtë punë. Pse të mashtrohemi, ne të gjitha këto nuk i kemi... kaq...

ABDYLI — Burra, vëllezër. Të kemi mendjen se çka po flasim. Po kam frikë se prej zemër-

ngushtësisë do të rrëshqasim në tradhti. Pra, t'i masim fjalët.

SULEJMANI — Po nuk qe ushtria e tubuar sipas zakonit, do të na dalin vështirësi të mëdha. Mobilizimi i përgjithshëm është i domosdoshëm.

(Përsëri në mbledhje mbretëron qetësia.)

YMER PRIZRENI — Sulejman, bisedat që i bëmë nuk tregojnë se nuk jemi me mendimin tënd. Prijna si di më së miri, e sa i përket mobilizimit, qe tek jemi të gjithë këtu dhe të gjithë të marrim përsipër që të kthehemi atje, prej kah kemi ardhur, ta vëmë në jetë këtë mendimin tënd.

SULEJMANI — Rrofsh, o Ymer Prizreni, edhe pse kam qenë i sigurt se në ty nuk ka fije frike, këso fjalësh flet kryetari i Lidhjes.

ABDYLI — Vazhdo, Sulo...

SULEJMANI — Ata që kanë pasur rast të takohen me ushtrinë e Dervish pashës kanë parë se ajo është e pajisur me topa të të gjitha madhësive. Për t'iu kundërvënë edhe ne, duhet sa më parë të armatosemi me armë të tilla.

(Përsëri qetësi.)

JONUZ ZAHDI — Kam frikë se topat do të pengojnë lëvizjen e shpejtë të forcave. Terrenet tona nuk e durojnë topin. Në anët tona vetëm pushka bën punë.

(Në bisedë ndërhyjnë edhe Abdylit.)

ABDYLI — Bëjnë punë edhe topat se jo mahi, vetëm duhet të shikojmë sa më parë se ku t'i

gjejmë. Ku t'i blejmë kur jemi të vetëdijshëm se...

JONUZ ZAHDI — Të katër anët e botës janë kundër nesh...

ABDYLI — Po, po kjo nuk duhet të na frikësojë po të na japë zemër.

JONUZ ZAHDI — Po kam frikë se shtëniet e topave tanë do të bëjnë zhurmë të madhe e atëherë shqetësohet dhe na hidhërohet Evropa.

ABDYLI — Dëgjo, Jonuz Zahdi, nuk e di se kush flet prej teje, po fjalëve të tua nuk u vjen erë e mirë. Ti si duket nuk e ke të qartë se Porta e ka dërguar Dervish pashën të na asgjësojë. Kurrkujt nuk po i pëlqen kjo që po bëjmë ne, por i pengon çdo gjë jona bile edhe ekzistenca e popullit tonë. The se të katër anët e botës janë kundër nesh... Mu për këtë ne duhet të luftojmë me të njëjtin zjarr si kundër diplomacisë së ftohtë të Evropës së Bismarkut, ashtu edhe kundër armëve të nxehta të Perandorisë Osmane, që i qiti në pazar të botës tokat tona që t'i shpëtojnë të vetat... Më fal, Jonuz Zahdi, por e përmende qetësinë e Evropës, asaj dhelpreje plakë. Të them se ne nuk duhet të na interesojë qetësia e saj përderisa nuk e kemi qetësinë tonë... kuptove?

(Qetësi. Një kohë kurrkush nuk flet. Në fund përsëri flet Jonuz Zahdi.)

JONUZ ZAHDI — Jo, nuk kuptova...

(Të pranishmit e shikojnë si diçka të çuditshme.)

JONUZ ZAHDI — Deri tash luftuam t'i ruajmë viset shqiptare nën Perandorinë Osmane e tash jemi ngritur edhe kundër saj...

ABDYLI — Kemi dashur që armiqtë të mos na shumohen... Duke i pasur të gjitha tokat tona vetëm nën Turqinë, në fund të fundit, do ta kishim më lehtë me të se me të dhe të tjerët. Turqia është shtet aziat, ajo ndonjëherë do të tërhiqet, do ta shporrim. Po, tash, mbasi i fali tokat tona si diçka të pavlerë, si diçka të vjedhur, neve nuk na ngeli tjetër shteg, pos të luftojmë edhe kundër saj, që ta mbrojmë këtë grusht dhe... Besoj se tash i ke të qarta të gjitha...

(Përsëri qetësi. E merr fjalën Sulejman Vokshi.)

SULEJMANI — Të kthehemi përsëri tek artileria... Me disa bateri topash do të mund të zinin pozitat në majë të grykave që të rrahim më mirë rrugët nëpër të cilat kalojnë batalionet e Dervish pashës.

(Përsëri në bisedë ndërhyjnë Jonuz Zahdi.)

JONUZ ZAHDI — Po nëse edhe i sigurojmë topat, edhe pse nuk i besoj kësaj pune, kush do të punojë me ta?

SULEJMANI — Kush?! E kush tjetër pos djemve tanë. Ata shpejt mund të nxajnë si përdoren. Më shpejt se mendon ti dhe unë. Neve kanë nisur pak të na lënë, e mendja e të riut e thith dijen si toka e etur ujin.

(Përsëri qetësi.)

ABDYLI — Nëse nuk mund t'i sigurojmë topat, atëherë duhet të bartim luftën në taboret

e Dervish pashës. Ashtu si e mori ai Shkupin duhet edhe ne të përvidhemi në ushtrinë e tij.

YMER PRIZRENI — Si?

ABDYLI — Në taboret e tij ka shumë nizamë shqip-tarë. Kjo duhet shfrytëzuar ashtu si i shfry-tëzojnë ata njerëzit tanë që jetojnë me ne e mendjen e kanë në Stamboll.

7.

SALLA E GJYQIT

Qamil beu është shumë nervoz, këtë e tregon me mënyrën e pakontrolluar të bisedës.

QAMIL BEU — Deri dje u kujdesëm për ju si për fëmijën tonë, e juve nuk ju vjen turp të flitni në këtë mënyrë për ne. A nuk ju kujtohet se prej gjysmës së 79-shit, pos gjyqeve tona, nisën të funksionojnë edhe gjyqet tuaja. Cili shtet tjetër do ta bënte këtë, cili? Askush pos Portës së Lartë.
(Nga vendi i vet ngrihet Sulejman Vokshi dhe, ashtu, pa pasur konsiderata ndaj Qamil Beut, mbasi të dy janë për afërsisht të një brezi thotë:)

SULEJMANI — As të zezët ndër thua nuk do të na jepshit me dëshirë, po e morëm vetë. Me viktima të mëdha. Jemi mësuar që asgjë të mos na shkojë lehtë.

(Ndërhyn Tursun beu, duke dashur të mbrojë Qamil beun.)

TUR SUN BEU — Kjo ishte dëshirë e padishahut, nurit të perëndisë e jo sukse si juaj.

SULEJMANI — Ne e kërkuam dhe pavarësinë, pse nuk na i dha padishahu ashtu si gjyqet?

QAMIL BEU — Të varfërit ia jep gishtin, ta shkëlqej dorën, të tillë jeni ju...

SULEJMANI — Asgjë nuk kërkuam nga ju. As që kërkojmë nga dikush. Çdo pëllëmbë të tokës së çliruar e kemi larë me gjak. Gjakova, Peja, Prizreni, Prishtina, Shkupi, Dibra, Shkodra, Elbasani për ne nuk janë vetëm qytete të çliruara po varreza të mëdha, varreza të bijve tanë.

(Në bisedë futet dhe Mexhid beu.)

MEXHID BEU — Ne nuk ju fajësojmë juve në atë masë sa ju po mendoni... E dimë se vendimet e Lidhjes janë fryt i mendimit të shumicës dhe natyrisht, edhe faji juaj do të ketë atë përpjesëtim.

SULEJMANI — Mos u mundoni të më lehtësoni fajin. Unë këtë nuk e ndiej për faj, po më të për mburrim me çdo fjalë të thënë në atë mexhlis të burrave. Çkado që do të ndodhë me mua, s'është asgjë tjetër pos fund i natyrshëm i rrugës që kam marrë. Pra, nuk kërkoj ndjesë nga kurrkush.

QAMIL BEU — Krenaria jote do të kushtojë shtrenjtë, o Sulejman Vokshi.

SULEJMANI — Le të kushtojë sa të dojë, jam gati ta paguaj, o Qamil bej.

(Abdyl Frashëri ngrihet, të gjithë e shikojnë, sepse një sjellje e tillë është e paparë gjerë tash në gjykim. Presin të flasë, presin të ndërhyjë dikush dhe, më në fund, ndërhyjnë Mexhid beu.)

MEXHID BEU – Dëshët diçka të thoni?

ABDYLI – Po, desha të pyes Qamil beun diçka.

(Mexhid beu e shikon Qamil beun.)

QAMIL BEU – Po të dëgjoj...

ABDYLI – Kërkoj ndjesë që u ngrita në këtë mënyrë, po, duke ju çmuar si njeri të zgjuar, më habitën fjalët tuaja që ia drejtuat Sulejman Vokshit.

(Të gjithë habiten me një trimëri të këtillë të Abdylit.)

ABDYLI – Mendoj se i drejtë është ai njeri që lufton për punë të drejtë, pa e shikuar interesin e vet. E, Sulejman Vokshi është njeri i tillë...

(Tash thuaje merr zemër Tursun beu edhe më me ngulm hyn në bisedë.)

TURSUN BEU – Nuk ju kemi ftuar këtu të mbronin Sulejman Vokshin po të përgjigjeni për fajet që nuk janë hiç më të vogla se ato për të cilat përgjigjet ai. Dhe të mos flisni pa e kërkuar nga ju një gjë të tillë. Mos harroni se gjendeni para gjyqit.

(Qamil beu tash e qetëson Tursun beun.)

QAMIL BEU – Tursun bej, uluni, ju lutem! Unë po bisedoj me Abdyl Frashërin. (Dhe vazhdon me Abdylin. ...Ne po mundohemi ta vëllazërojmë fuqinë dhe drejtësinë... Në më-

nyrë që, ajo që është e drejtë të jetë edhe e fortë... E ajo që është e fortë të jetë edhe e drejtë... Nëse nuk pajtoheni me mua duhet të të përkujtoj se të dy anët e shkopit janë në duart tona...

E sa i përket kësaj, Lidhjes suaj, t'ju përkujtoj se gjithçka ka kohën e vet... si lindja e fëmijës... Nuk bën as më herët as më vonë... Ndoshta, një ditë do të vijë edhe koha juaj, ndoshta... Atëherë vetë do të kuptoni se sa të marrë ishit në kohën e sotme...

ABDYLI — Asnjë kohë nuk vjen vetvetiu... edhe kohës sonë edhe fëmijës i duhet ndihmuar që të dalë në dritë...

(Qamil beu shkapërthen uniformën, merr frymë rëndë, shihet se nuk i ka punët mirë me zemrën. Po këtë kohë dëgjohen fjalët e Abdylit.)

ABDYLI — Mjerë ata që nuk dinë se vetëm lufta për liri ia drejton qëllimin jetës së njeriut.

(Mexhid beu ndihmon shpejt Qamil beun, me të shpejtë aty gjendet edhe Tursun beu.)

TURSUN BEU — Mbaroi beu, ujë, ujë...

(Skëna errësohet)

8.

TE KONSUJT

Konsulli austro-hungarez vjen te konsulli rus dhe posa ia jep mantelin shërbëtorit, menjëherë ia nis.

KONSULLI AUSTRO-HUNGAREZ — A dëgjove për sëmundjen e Qamil beut. Është ky një lajm që kurrkush nuk e ka pritur në mes të gjyqit.

KONSULLI RUS — Dëgjova... Si duket ka angina pektoris.

KONSULLI AUSTRO-HUNGAREZ — Dhe ti u besove këtyre llafeve?!... Angina pektoris... Përralla për më të vegjlit. Dragomani im ka dëgjuar se për punën e Qamil beut fajtor kryesorë janë fuqitë e fshehta të Lidhjes që ende veprojnë...

KONSULLI RUS — Nuk është e mundur. Lidhja u shua. Bile ç'është e mira, në gjak. Mos t'iu bjerë më ndër mend një punë e tillë.

KONSULLI AUSTRO-HUNGAREZ — Mashtrohesh, mik i dashur, mashtrohesh, nuk mund t'i mäsësh këta njerëz me arshinin tënd rus... Plas in aty ku aspak nuk e pret. Lidhja lindi nga populli, u ngrit ashtu, si valë nga fundi i detit, që shkon gjithnjë duke u rritur dhe më në fund sa për sy e faqe qetësohet, gjer sa të arrijë vala tjetër. Të thuash se nuk ekziston më, do të thotë të mohosh shumë çka. Lidhja jeton, aty në popull ka pulsën e saj që, veshi ynë nuk e ndien... Ne e ndiejmë vetëm kur plas. E atëherë është vonë...

KONSULLI RUS — Nuk të kam parë kurrë të tillë... Qetësohu...

KONSULLI AUSTRO-HUNGAREZ — Thuaj, një gjë të tillë kurrë nuk do ta parashikoja... Ta helmojnë kryetarin e gjyqit...

KONSULLI RUS — Nuk besoj se është farë helmi mi. Mjeku i tij kryesor, njëfarë Limini, francez, thotë se nuk është asgjë tjetër pos një inflamacion i fuqishëm i zemrës dhe se, pas ca ditësh, do të kalojë... Të paskan frikësuar shumë këto lajme...

KONSULLI AUSTRO-HUNGAREZ — Natyrisht... Kam gjellbërësin shqiptar... Unë nuk kam atë fat të jem i martuar si ti. Edhe mua dikush duhet të më përgatis ushqimin...

KONSULLI RUS — Cfarë arsyeje kanë shqiptarët të të helmojnë ty? ...Austro-Hungaria, të cilën ti e përfaqëson, është mik i madh i popullit shqiptar, apo jo?

*(Shihet qartë ironia në fjalët e konsullit rus.
Edhe konsulli austro-hungarez mundohet t'ia
kthejë në të njëjtën mënyrë...)*

KONSULLI AUSTRO-HUNGAREZ — Natyrisht!

KONSULLI RUS — Dëshiron diçka të pish?...

KONSULLI AUSTRO-HUNGAREZ — Jo. Të falem-
nderit!... Mjeku ma ka ndaluar.

KONSULLI RUS — Mjeku?!

KONSULLI AUSTRO-HUNGAREZ — Po, mjeku...

*(Konsulli rus qesh, dhe qeshjes së tij i bash-
kangjitet edhe ajo e konsullit austro-hun-
garez.)*

9.

GJYQI

Në vendet e veta ulen Abdyl Frashëri dhe Sulejman Vokshi. Të dy kësaj here janë më të zbehur se herët e kaluara. Nga ana tjetër e sallës dëgjohet zëri i Tursun beut.

TURSUN BEU — Me keqardhjen më të madhe duhet të lajmëroj se prej ditës së sotme, 22 nëntor të vitit 1885, këtë gjyq nuk do ta kryesojë Qamil beu, oficer i lartë i shërbimit të sigurimit. Por unë, Tursun beu, oficeri i shërbimit të sigurimit. — Abdyl Frashëri, ngrihuni!
(Abdyl i ngrihet.)

TURSUN BEU — Po e keqpërdorni mëshirën që ka ky gjyq ndaj jush dhe po përpiqeni të zhvillonin propagandë armiqësore kundër nesh, edhe këtu. Kini mendjen, punë të tilla nuk i duroj...
(Abdyl do të flasë.)

TURSUN BEU — Kurtkush nuk ju dha fjalën. Do të përgjigjeni kur t'ju pyes. Kuptuat?
(Abdyli nuk përgjigjet. Qëndron në këmbë thuasë nuk dëgjoji se çka i tha Tursun beu. Është i tretur diku në mendime.)

TURSUN BEU — Cilat kanë qenë lidhjet tuaja me shehun e Tetovës?
(Abdyli mendohet a t'i përgjigjet apo jo dhe, më në fund thotë:)

ABDYLI — Lidhje shqiptarësh... Lidhje intelektualesh...

TURSUN BEU — Pas kthimit të tij nga Stambolli, ku ishte në audiencë te padishahu, u takuat në Selanik, në shtëpinë e Thanas Timos, një shqiptari ortodoks, ju, Pashko Vasa edhe shehu i Tetovës. Kjo ndodhi në dhjetor të vitit 1878. Këtë informatë, a mund ta konfirmoni si të vërtetë?

ABDYLI — Pse jo?

TURSUN BEU — Për çka biseduat?

ABDYLI — Duke ditur se cili është autoriteti i tij në Stamboll, kemi kërkuar nga ai të inter-venojë për lirimin e disa të burgosurve nga burgjet otomane.

TURSUN BEU — Nuk është e vërtetë. Ju atë natë jeni munduar ta bindni atë të bashkëpunojë me ju. T'ju shërbejë si spiun nga Porta e Lartë.

ABDYLI — Keni prova për një gjë të tillë?

TURSUN BEU — (Thërret.) Dëshmitari Idriz Sumo!
(Rojat menjëherë thërrasin dhe me të shpejtë paraqitet ai. Është burrë i moshës 35-40 vjeçar i veshur qytetarç.)

TURSUN BEU — A e njihni këtë njeri?

ABDYLI — Jo.

TURSUN BEU — E ju këtë njeri?

IDRIZ SUMO — Po, është Abdyl Frashëri. Për herë të parë e kam parë në shtëpinë e Thanas Timos në Selanik, kur erdhën me Pashko Vasën dhe sheh efendinë e Tetovës. Aty u shërbeja me kafe.

TURSUN BEU — Çka tha aty Abdyl beu?

IDRIZ SUMO — U mundua ta bindë sheh efendinë të spiunojë Portën e Lartë.

ABDYLI — (Me ironi të thellë.) Dhe të gjitha këto biseda i bëmë para teje?

IDRIZ SUMO — Po.

ABDYLI — O i mjerë, sa të kanë paguar të gënjeshtës kështu.

TURSUN BEU — Asgjë. Me këto fjalë dëshmon besimin që ka në të madhërishtin padi-shah. (Idrizit.) Mund të shkoni. (Pastaj Abdylit.) E dëgjuat?

ABDYLI — E dëgjova. Është turp të më bëni provokime të këtilla me dëshmitarë të rrejshëm. Nëse vazhdoni kështu, nuk do t'i përgjigjem asnjërës prej pyetjeve tuaja. (Për një moment në gjuq mbretëron qetësia. Mexhid beu i thotë diçka me ngadalë Tursun beut.)

TURSUN BEU — Nuk mundem pa jua thënë këtë në fytyrë, loja juaj gjatë tërë kohës ishte kundër nesh... Në fillim edhe ju luftuat për program të Kararnames, por tash është fare e qartë se tërë këtë e paskëshit bërë vetëm sa për sy e faqe, të na hidhnit pluhur syve.

ABDYLI — Perandoria Osmane kurrë nuk ka qenë për zgjidhjen e drejtë të çështjes shqiptare.

TURSUN BEU — Nuk është e vërtetë. Porta në fillim e përkrahu Lidhjen.

ABDYLI — Asaj nuk i thuhet përkrahje, por interes.

MEXHID BEU — Nuk është mirë, Abdyl, të flasësh në këtë mënyrë. Ne jemi munduar aq sa kemi pasur hapësirë nga Paqja e Shën-Stefanit.

ABDYLI — Jeni munduar për vete, jo për ne. Këtë e kam ditur që nga fillimi, e dija se herët a vonë do të kryste konflikti me ju... Vullneti i popullit nuk mund të ndalet. Ta them, Mexhid bej edhe këtë: pa zgjidhjen e drejtë të çështjes shqiptare nuk do të ketë qetësi as Turqia, as Evropa.

(Për një moment mbretëron qetësia dhe më në fund:)

TURSUN BEU — Me ju nuk kam çka të flas më. Tash e tutje do të flasë me ju veç ligji. Uluni!

ABDYLI — Nëse e keni.

TURSUN BEU — *(Gërthet.)* Uluni!

(Në sallë mbretëron qetësia.)

TURSUN BEU — Sulejman Vokshi, ngrihu!

(Sulejmani ngrihet.)

TURSUN BEU — Nga të dhënat që kemi dhe nga procesi i hetimeve, del padyshim se ju jeni fajtori kryesor edhe për marrjen e Shkupit.

SULEJMANI — Për çlirimin e Shkupit.

TURSUN BEU — *(Shikon dokumentin para vetes.)*
Në 4 dhjetor të 1800-shit nuk e keni lejuar mytesherif Raif efendinë të hyjë në Shkup.

SULEJMANI — Po.

TURSUN BEU — Duke menduar se Shkupi gjithmonë do të ngelë në duart tuaja dhe se mytesherif Raif efendiu, mbasi shkoi në Selanik, nuk do të ketë guxim të kthehet më, u bëtë aq të paturpshëm dhe i ndaluar drejtorisë së hekurudhës Selanik-Shkup të bëjë transportimin e ushtrisë osmane në cilindo drejtim, qoftë nga Shkupi në Selanik apo anasjelltas.

SULEJMANI — Po. I kam ndaluar. Në territorin tonë të çliruar komandonim ne.

(Për një moment heshtja e kaplon gjyqin.)

MEXHID BEU — Si nuk ju vjen turp të flisni kështu.

SULEJMANI — Dëgjoni, Mexhid bej, duke ju shikuar kështu juve, në atë anë dhe vetveten në këtë anë, po më duket se pak kam bërë. Është dashur edhe më shumë të bëja, do të vdes në atë ixhram.¹⁾

MEXHID BEU — Po më habitni. Njeri në moshë edhe me përvojë të flasë kështu në një vend si është ky!

SULEJMANI — Të gjitha i kam bërë me të vetmin qëllim: ta luftoj pushtetin tuaj.

MEXHID BEU — Më interesojnë rrënjët e mllëfit kundër nesh.

SULEJMANI — Na morët lirinë, na i morët të gjitha. Kurrë nuk u ngopët me gjakun tonë. Në fund dhe në pazar të botës na qitët të na ndërroni si lecka të vjetra, si harnën

1) vendim.

vetëm e vetëm të shpëtonit kokën tuaj. Unë nuk jam i mençur si Abdyli, e ky këto punë do t'ua thoshte më mirë, por unë desha t'ju them të vërtetën që më flen në zemër.

TURSUN BEU — Nuk keni nevojë më tepër të flisni. Se lufta juaj e armatosur i ka sjellë dëme të mëdha Portës, këtë e keni ditur edhe ju. Kjo ju ka gëzuar dhe ju ka dhënë vullnet për aksione të reja, mirëpo se aktiviteti juaj u ka sjellë dëme edhe fqinjëve tuaj të lagjes së Haxhymerët, këtë nuk e keni ditur, por do ta mësoni tash...

(Rreh shuplakat dhe roja hap një derë, prej nga del i lidhur plaku i lagjes së Haxhymerit. E shoqërojnë dy roja. Sulejmani habitet kur e sheh. Sa është prezente habia në fytyrën e Sulejmanit, aq është kënaqësia në atë të Tursun beut.)

TURSUN BEU — E dini pse gjendeni këtu?

PLAKU — Jo.

TURSUN BEU — I njihni këta njerëz?

PLAKU — Sulejman Vokshin po, këtë tjetrin jo.

TURSUN BEU — A e ke parë edhe ndonjëherë tjetër Sulejman Vokshin.

PLAKU — Po qysh.

TURSUN BEU — Dhe nuk keni ardhur të na lajmëroni?

PLAKU — Është e vërtetë, nuk kam ardhur...

TURSUN BEU — Pse?

PLAKU — E pse të vi e t'ju lajmëroj... Njerëzit kanë ardhur në shtëpi të vet... E sa për Sulejmanin, mund të them se është burrë

që për gjak nuk vritet... Para se të vazhdoj, do t'ju pyesja juve, kadi efendi, për çfarë burrë do të më mbanit sikur të vija e të tregoja për fqinun tim, për atë që me qindra herë ma ka këputur lakun. Jo, nuk keni nevojë të thoni, e di unë, do të thoshit se jam njeri i poshtër... Tradhtar... E besa, t'ju them edhe këtë, Sulejman Vokshi me shokë, është, si thotë populli, ujk që punët i rregullon vetë.

MEXHID BEU — Shihesh se je burrë i ndershëm, po duhet të të përkujtojmë se padishahu për këso farë punësh të humbë me tërë familjen, më larg se Kastamonia...

PLAKU — Shumë bukur, besa... Kurrë nuk kam dalë jashtë kësaj kazaje. Ajo, që padishahu merret me punë të mia, më bën nder të madh... Në mes të këtij qejfi, që më ofron vetë padishahu në Koptamoni, Rodos e gjetiu dhe asaj që të tradhtoj, unë do të zgjidhja syrgjunllëkun.

TURSUN BEU — Ke ardhur këtu të tallesh me ne?

PLAKU — Qoftë larg, erdha pse më keni thirrur, e, unë u përgjigjem pyetjeve të zotërisë suaj... T'ju them të drejtën, unë nuk kam faj, poqese ju duken qesharake përgjigjet e mia...

TURSUN BEU — Atëherë përgjigjuni si duhet!

PLAKU — Dëgjoni... Nuk jua kam frikën... e di se do ta bëni punën tuaj edhe pa përgjigjet e mia... Po në fund kam për detyrë t'ju them se kot e keni që më pyesni për këta burra. Do të nisesha pas tyre poqe se do të më

thërrisnin edhe në atë dynja, përndryshe do të skuqeshin për mua edhe fëmijët e fëmijëve të mi, keq...

(Tursun beu jep shenjë me kokë dhe rojat, që gjenden aty, e tërheqin me dhunë të lidhur. Tursun beu i kthehet përsëri Sulejman Vokshit, që gjatë tërë kohës ka qëndruar më këmbë.)

TUR SUN BEU — E patë këtë njeri... Do të dënohet me vdekje se ka bashkëpunuar me ju... Se nuk na ka lajmëruar se kah silleni... E, të atillë ka mjaft... Mund të them se ju jeni fajtori kryesor për vdekjen e tyre...

SULEJMANI — Tursun bej... Jeni më i ri se unë. Po shihemi këtu dhe shyqyr zotit e njohim njëri-tjetrin. Unë nuk mendoj mirë, po dhe nuk pres që ju të mendoni mirë për mua. Sollët këtu atë të shkretë nga lagjja ime, të tregoni se sa të fuqishëm jeni e se si unë kujdesem për të afërmit e mi, se jam i pazemër, shumë mirë, besa. E, ju jeni njerëz me zemër... Si tha Qamil beu, të dy anët e shkopi janë në duart tuaja. Mbajeni, se ju duhet... Shkopi dhe arma të cilat neve na e morët me aq dhunë, janë dy gjëra që ju duhen aq shumë, po dijeni se edhe me to nuk do të keni gjumë të qetë. Do t'ju shtihen në ëndrra Mic Sokoli, Sef Kosharja e shumë e shumë të pafajshëm nga fshatrat e djegura që i latë pas. Të vdekurit natën do t'ju bëjnë ferr të gjallë ditën. Kot më sillni njerëz këtu. Unë timen e kam bërë. Po të kisha edhe tri jetë, që të tria do t'i

kaloja në luftë për lirinë e atdheut tim.
Mos më thërrisni më të përgjigjem. Asgjë
më tepër nuk kam ç'të them...

(Ulet. Në gjyq mbretëron qetësia. Të gjithë janë të hutuar. Në mes atyre, që u duket plotësisht e pakuptimtë pozita është qatipi, që herë shikon Tursun beun, herë Mexhid beun herë Sulejmanin me Abdylin.

Skena errësohet ngadalë.)

10.

BURGU

I përcjellë nga një roje, ecën nëpër korridoret e burgut Mexhid beu. Vjen deri te qelia ku është mbyllur Abdyli. Roja, pa folur, hap derën dhe hyn brenda. Pas tij edhe Mexhid beu. Abdyli ngrihet në këmbë. E habit ardhja e Mexhid beut në burg. Mexhid beu shikon rojen dhe e urdhëron.

MEXHID BEU — Zgjidhe!

(Ndërsa roja zgjidh Abdylin, Mexhid beu shikon qelinë. Abdyli është në setër dhe shihet se ka të ftohtë. Pas pak Mexhid beu hukat duart, i fërkon dhe shikon Abdylin drejt në sy. Gjatë këtij shikimi shihet qartë se Mexhid beu don të përtërijë miqësinë që ka pasur dikur me Abdylin, por si duket nuk mundet. Ftohtësia e shikimit të Abdylit thuhet se çarmatosi Mexhidin.)

MEXHID BEU — A ke të ftohtë?

ABDYLI — Ashtu... Po lagështi ka shumë, po ma zë frymën... Pse zbrite kaq poshtë?
(Mexhid beu nuk i përgjigjet, bën disa hapa nëpër qeli. Shikon rojen, mendohet të flasë apo jo...)

MEXHID BEU — *(Rojës.)* Dil jashtë!...
(Roja del jashtë. Ngelin të dy vetëm.)

ABDYLI — Pse zbrite kaq poshtë?...

MEXHID BEU — Poshtë të duket?
(Abdyli nuk i përgjigjet, shikon kah dritarja...)

MEXHID BEU — Mua po më duket shumë larg...
Shumë larg... E sa afër ishim dikur.
(Përsëri qetësi...)

MEXHID BEU — Të shikoja në gjyq... Njeri krejtësisht tjetër prej atij që e njihja në studime...

ABDYLI — I këtillë kam qenë gjithmonë, por atëherë ty nuk të kanë interesuar problemet e mia se nuk kanë qenë edhe të tuat. Tash që të kam prekur në interesat e tua të dukem i largët ...Njeri tjetër... Tash më sheh çfarë jam...
(Mexhid beu sillet përsëri nëpër qeli... Prek muret dhe pastron duart...)

MEXHID BEU — Kjo lagështi... ky terr ka ndikuar të flasësh kështu?...

ABDYLI — Dëgjo, Mexhid bej!

MEXHID BEU — Nuk ke nevojë të më thuash Mexhid bej. Këtu kam ardhur vetëm si Mexhid, si shoku yt...

ABDYLI — Ti këtu ke ardhur si Mexhid bej, unë kam edhe shumë shokë që nuk mund të vijnë kështu si t'u teket...

MEXHID BEU — Mos harro se edhe ti je Abdyl bej...

ABDYLI — Jo. Jam vetëm Abdyl Frashëri...
(Përsëri qetësi, përsëri Mexhid beu ecën nëpër qeli, përsëri prek murin e kështu me radhë...)

MEXHID BEU — Më duhet të të them këtë, që nuk kam mundur në gjyq... Bjeri inqarë¹⁾ atyre që ke thënë më parë, e çdo gjë do të rregullohet.

(Abdyl shikon, thujse nuk mundet t'u besojë syve as veshëve të vet. Është kjo një qetësi e mundimshme. Asnjëri nuk lëviz. Edhe Mexhid beu nuk lëviz më, po rri dhe e shikon. Kur nuk mundet ta durojë shikimin e tij, shikon në tokë, para vetes.)

ABDYLI — Abdyl të tradhtojë?!

(Tash Mexhid beu nuk i përgjigjet.)

ABDYLI — Kush të ka dërguar të flasësh me mua?... Tursun beu?... Qamil beu?... Apo dikush me pozitë më të lartë?...

MEXHID BEU — Kurrkush nuk më ka dërguar.

ABDYLI — Do të thotë, ti po më këshillon të tradhtoj.

MEXHID BEU — Nëse ngel me këtë mendim... tradhton vetveten... gruan, fëmijët që ende nuk i ke lindur...

1) mohoi

(Abdyli një herë nuk i përgjigjet. Mexhid beu vazhdon.)

MEXHID BEU — Dëgjo, Abdyl, pas sa e sa vjetëve, që merresh me këtë punë, duhet t'i kesh ca gjëra të qarta... Pavarësisht nga vullneti yt, nga ajo që ti do, populli i vogël kurrë nuk është zot i vetvetes. Çdo luftë, çdo hap e bëni duke menduar se është fryt i mendjes suaj, i etosit tuaj kombëtar, e në të vërtetë nuk është asgjë tjetër pos dëshirë e shteteve të mëdha.

ABDYLI — Ky është mendim i atyre që imponojnë dorëzimin...

MEXHID BEU — Jo... E di se ia kam qëlluar e ti nuk do as para vetes të pranosh një mendim të tillë, po kam të drejtë. Jo unë, po historia... Ai thesari i pafund i përvojës... Vriteni ndër luftëra, populli ju këndon këngë, e pak kush di se nuk jeni asgjë tjetër pos figurë shahu në një lojë të madhe që e luan tjetri.

ABDYLI — Mexhid bej, je marrë shumë me kuran. Atje, me sa duket, thuhet se njeriu çkado që bën, bën vetëm atë që i është shkruar nga perëndia... Ti këtë mundohesh ta aplikosh në popuj të vegjël dhe të mëdhenj, besoj se gabon... Ajo histori, për të cilën më flet, do të demantojë këtë mendim; vdiqa unë apo jetova, kjo nuk ka rëndësi... Fati i një njeriu kurrë nuk mund ta ndalë rrjedhën e saj... Më mirë mos të kishe ardhur... Do të të kujtoja si një shok të mirë, si mik që di të çmojë miqësinë dhe burrë-

rinë. Po ti ke ardhur, dhe po ta them...
(*Një pauzë e shkurtër në të cilën Abdyl i mendohet se si të flasë...*) Një kohë të gjatë kemi qenë shokë... Është dashur të dish se nuk jam njeri që kthehet andej nga fryn era... Po, edhe sikur të isha, ti, si shok i mirë duhej të më bindje t'u isha besnik mendimeve të drejta...

MEXHID BEU — Më intereson vetëm shpëtimi yt e asgjë tjetër...

ABDYLI — ...Eh... Pavarësisht nga shoqëria, njerëz të tjerë jemi... Dëgjo!... M'i përmende fëmijët e palindur, çka mendon, a do ta donin ata një baba që heq dorë nga mendimet e veta liridashëse për të cilat kanë vdekur qindra e qindra njerëz?
(*Mexhid beu nuk i përgjigjet. Është ulur në një karrige afër dhe hesht.*)

ABDYLI — Nuk ke menduar kurrë për një punë të tillë, se, nuk të ka rënë... E di ç'është njeriu pa mendimin e vet? Send i vdekur dhe asgjë tjetër... Para disa ditësh e varët një djalë. Buza i qiste qumësht. ...Kishte ikur nga karavani i nizamëve. E di se kush është fajtor që ai ka ikur?... Nuk e di. E dije, pra! Jam unë. Fjalët e mia... Mendimet e mia... E ai, ecte drejt vdekjes dhe këndonte...
(*Përsëri heshtje. Abdyl i ngrihet, afrohet te dera. E prek. Ajo është e hapur. E çel dhe e mbyll përsëri dhe ashtu nga dera i kthehet Mexhid beut.*)

ABDYLI — Nëse do të hiqja dorë nga rruga ime do të jetoja gjatë, do të kisha një post të

lartë, qoftë këtu, qoftë në ndonjë anë tjetër të Perandorisë... Apo jo?...

MEXHID BEU — Sigurisht! Post me rëndësi të madhe... Ashtu ka thënë vetë sulltani...
(Abdyli e shikon, habitet si ai nuk mundi ta kuptojë ironinë e tij.)

ABDYLI — Ta them një mendim që ma tha një plak kosovar: «Biro, ruaju lakmisë se, sa më shumë të kesh, aq më pak je i vetvetes...»

MEXHID BEU — Të them unë një mendim tjetër... Zoti ta ka dhënë jetën ta jetosh... Detyra jote e parë është që këtë jetë ta ruash patjetër.

ABDYLI — Mexhid bej, ta them troç se ashtu po e lyp... Postin që ma ofron ti, është post që ma ofrojnë armiqtë. Nëse e pranoj, ta dish nuk do të më çmonin as miqtë as armiqtë. Turqit do të thoshin, kur për një post i shiti të vetët, po neve, kundër të cilëve luftoi, për sa do të na shesë... Edhe sikur të kisha luajtur menç e të pranoja atë që më ofron ti, a e di se kush do të jetonte? Turpi im. Unë jo... E ju do të më ushqenit si derrin me gjellërat më të mira që ka shpikur Lindja, do të më ofronit të palavitesha ndër shtretër të mëndafshhtë stambolli, e vetmja arsye e ekzistencës sime do të ishte edephanja!¹⁾ Vetë mendimi për një punë të këtillë më shtyn të vjell. Po ta pranoja këtë propozimin tënd, do të vdisja për-

1) Vend korrektimi

jetë... Do të isha kufomë që ecën e kundërmon.

(Qetësi dhe, pas pak.)

ABDYLI — Më beso se kufomat e tilla kurrë nuk i kam dashur...

(Mexhid beu rri edhe pak ashtu i turpëruar. Dikur thërret.)

MEXHID BEU — Roje!

(Roja hyn me të shpejtë dhe rri gatitu para tij.)

MEXHID BEU — Lidhe!

(Roja me mundim e lidh, ndërsa Abdylë qëndron kokëlart.)